



Hyn në fuqi udhëzimi, si do të funksionojë kompensimi 10% për TVSH-në e fermerëve

Faqe 5



Garancia sovraane në bujqësi, interes të ulët - Financat, Bujqësia dhe BSH, takim me bankat: Orientoni fermerët drejt skemës

Faqe 3



Siguria ushqimore, Salla: Ngremë 7 pika të inspektimit kufitar, forcojmë AKU dhe ISU për kontrollin e import/eksporteve

Faqe 4



# AGROBIZNESI



## BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445  
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit shkurt 2026

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 527  
Çmimi 125 lekë

E përdryjavshme e pavarur

# BASHKËPUNIM PËR RRITJEN E KREDITIMIT NË BUJQËSI

## KREDI ME 2% INTERES DHE 70% KOLATERAL TË MBULUAR - KUSH PËRFITON NGA INSTRUMENTI I GARANCISË SOVRANE NË BUJQËSI?

Nën drejtimin e Ministrit të Financave, Petrit Malaj, me pjesëmarrjen e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, si dhe Drejtorëve të Përgjithshëm të bankave tregtare që operojnë në vend dhe përfaqësuesve nga Shoqata Shqiptare e Bankave, u diskutua mbi financimin e bujqësisë. Skema e Garancisë sovraane për bujqësinë, për herë të parë, mbështet drejtpërdrejt fermerët dhe ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin bujqësor dhe agropërpunues, me një fond prej 3 miliardë lekësh (30 milionë euro).

GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

ALBANIA

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Mbi 65 mijë fermerë përfituan nga Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi 2025



Faqe 2

### INTERVISTA

"Perimet, kryesore në eksportet me BE", Rrapaj: Objektiv 1 miliardë dollarë, i arritshëm. Fokusi ynë, cilësia...



Faqe 2

### EKSPORTET

Shqipëri-Kosovë, bashkëpunim doganor në shërbim të tregtisë dhe bizneseve



Faqe 7

### ANALIZË



Shqipëria po humbet tregjet e rajonit

Faqe 11

### TEMA TË DITËS

- Laborator i ri për analizën e mbetjeve në bujqësi, bashkëpunim UBT-AKUK Fq.4
- INSTAT- Kriza e blegtorisë, importet e bulmetit u rritën me 62% ndërmjet 2021-2025 Fq.4
- Salla dhe Kumbaro në dialog me fermerët e Gjirokastrës: Mbështetje për blegtorinë si shtyllë kryesore e ekonomisë së zonës Fq.6
- Miratohet marrëveshja Interreg Europe, Shqipëria përfiton fond për bujqësinë dhe agroturizmin Fq.6
- Bujqësia, midis konsolidimit dhe rënies Fq.10
- Zogjtë e muajit të lindjes - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

# Siguria ushqimore, ministri Salla në KKIE: 20 milionë dollarë investime në pikat kufitare dhe 130 akte të reja ligjore brenda 2026

Ministri i Bujqësisë, Andis Salla, ka raportuar në Këshillin Kombëtar të Integritimit Evropian (KKIE), duke shpalosur planin e qeverisë për të përfunduar standardet e sigurisë ushqimore me ato të Bashkimit Evropian.

I pranishëm në KKIE ishte edhe kryetari i Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar Agim Rrapaj.

rreth 90 akte nënligjore për sigurinë ushqimore, 10 për fushën fitosanitare dhe 31 akte të tjera për veterinarinë përgjatë periudhës 2026–2027.

## Investime në infrastrukturë

Ministri Salla vuri theksin te investimet fizike. Ai njoftoi një paketë investimi prej 20 milionë

vetëm në përafrimin e legjislacionit, por kërkon ndërtimin e një sistemi kontrolli efektiv, të barasvlefshëm me atë të BE-së,” theksoi Salla.

Këto pika kufitare, së bashku me fuqizimin e laboratorëve të ISUV dhe AKU-së, synojnë të garantojnë kontroll të rreptë të çdo produkti që hyn apo del nga Shqipëria.

## Cilësia e qumështit dhe mbështetja gjermane

Një vëmendje e veçantë iu kushtua cilësisë së qumështit të papërpunuar, një nga sfidat kryesore të sektorit blegtoral. Ministri nënvizoi rëndësinë e projektit “EU for Food Safety”, i mbështetur nga qeveria gjermane, i cili po asiston në përgatitjen e Programit Kombëtar për standardet e operatorëve të biznesit ushqimor.

Sipas Sallës, qëllimi final është zbatimi i zinxhirit të sigurisë “nga ferma në tavolinë”, për të rritur besimin e konsumatorit shqiptar dhe për t’u hapur rrugë eksporteve shqiptare në tregun e përbashkët evropian.



Gjatë fjalës së tij, ministri bëri të ditur se viti 2026 do të jetë vendimtar për plotësimin e kuadrit ligjor. Ai njoftoi se janë planifikuar të miratohen

dollarësh, e cila do të shkojë për ndërtimin e shtatë Pikave të reja të Inspektimit Kufitar.

“Përmbushja e kërkesave të Kapitullit 12 nuk kufizohet

# “Perimet, kryesore në eksportet me BE”, Rrapaj: Objektivi 1 miliard dollarë, i arritshëm. Fokusi ynë, cilësia...

Agim Rrapaj nga Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar theksoi se perimet, frutat, vaji i ullirit dhe peshku janë produktet kryesore që duhet të promovohen për eksport në BE.

Ai shtoi se zhvillimi i agroindustrisë dhe eksporti i produkteve të gatshme me standarde të larta janë kyç për të arritur objektivin e 1 miliard euro eksport brenda 2030. Rrapaj nënvizoi gjithashtu rëndësinë e standardizimit dhe cilësisë, duke theksuar se

produktet pa cilësi nuk lejohen as në tregun shqiptar dhe as në atë evropian.

“Perimet janë kryesoret në eksportet në BE, edhe frutat, vaji i ullirit dhe të tjerat duhet të jenë në vëmendje të fermerëve për të eksportuar në BE. Edhe peshku do të vijojë të eksportohet në BE. Ne duhet të zhvillojmë agroindustrinë dhe produktet e gatshme do të kenë prioritet të eksportohen, që të kapim objektivin 1 miliardë brenda 2030, i mundur plotësisht.

Ne kemi një ambient të madh për të prodhuar për vendet e BE, problemi është rendimenti. E dyta është cilësia dhe standardimi; çdo gjë mund të negociohet me BE, por në tregun e tyre produkte pa cilësi nuk do lejohen. Jo vetëm në BE, por edhe në tregun shqiptar nuk do lejohen produkte pa cilësi, ndaj ne kemi një projekt me shtetet e bashkuara që po punon prej 3 vitesh në Shqipëri për standardet dhe cilësitë.”



# Shqiptarët duan verën e huaj - U importuan brenda një viti 6.5 milionë litra, ekspertët: Ja çfarë i dëmton fermerët

Shqiptarët nuk e preferojnë verën e prodhimit vendas kjo shihet edhe tek të gjithë ekspozitorët e restoranteve të cilat janë të mbushura me verë të huaj

Sipas të dhënave doganore gjatë vitit 2025 në vendin tonë janë IMPORTUAR 6,548,000 litra ku dominohet nga vera italiane, kosovare dhe franceze me çmime që variojnë nga 80-600 lekë/litrë verë.

Ndërsa vera premium mbërrin nga Holanda dhe Spanja në shuma nga 1000-4000 lekë, por kjo në një sasi tepër të vogël.

Nga ana tjetër kantinat tona po në të njëjtin vit prodhuan 1,502,000 litra verë.

Fakti që ne bëjmë gëzuar me verë që prodhohet jashtë kufijve tanë, nuk do të thotë që vera e shtëpisë nuk është cilësore. Sipas ekspertëve të bujqësisë vera e importit e konkurren atë të vendit në sasi dhe çmim, por kurrësi në cilësi. Por për verën e shtëpisë bëhet shumë pak marketing.

Eksperti i bujqësisë, Agim Rrapaj thotë: “Arsyeja kryesore është se Shqipëria në marrëveshjen që ka me BE ka pranuar që një kuotë verë të hyjë pa taksa. Kjo bën që njësitë e shitjes në vendin tonë të preferojnë këtë verë sepse e

shesin me një çmim 4-5 herë më shumë që ka më tepër le-

shqiptare. Ne kemi kërkuar këtë tek Ministria e Bujqësisë



verdi. Ndërsa vera shqiptare është e prodhuar nga rrushi dhe njëkohësisht nuk ka marketing.”

Në shtetet e tjera produkti vendas mbrohet jo vetëm duke e mbështetur financiarisht, por edhe duke i ofruar një klimë të mirë biznesi, që të vijë sa më lehtë në tryezën e konsumatorit.

“Shumë vende e kanë zgjidhur këtë që i detyrojnë OBU që të kenë një stendë më verë

dhe ajo e Ekonomisë, ku të detyrojnë të gjitha njësitë e shitjes që verën shqiptare kenë në tregun e tyre. Kjo gjë nuk bëhet”, shton eksperti.

Ata që dëmtohen më shumë nga kjo zgjedhje, janë fermerët e vreshtave dhe prodhuesit e verës të cilët prej vitesh në kantinen e tyre u ka mbetur stok produkti i verës, edhe pse vera jonë në Europë është vlerësuar me pikët maksimale të shijes dhe cilësisë.

# Mbi 65 mijë fermerë përfituan nga Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi 2025

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZhBR) njoftoi se 65.435 fermerë në të gjithë vendin kanë përfituar nga pagesat e drejtpërdrejta të Skemës Kombëtare të Mbështetjes në Bujqësi për vitin 2025, me një fond total prej 5,152 miliardë lekësh.

Sipas AZhBR-së, përmes tetë masave mbështetëse, skema ka synuar të mbështesë sektorët kryesorë të prodhimit bujqësor dhe blegtoral, duke

sisë në vend.

Drejtoresha e AZhBR-së, Ardita Kuçi, ka thënë se kjo mbështetje financiare përbën një instrument të rëndësishëm për fuqizimin e fermerëve dhe përmirësimin e standardeve të prodhimit.

“Kjo mbështetje kontribuon drejtpërdrejt në uljen e kostove, rritjen e konkurrueshmërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor në të gjithë vendin”, ka theksuar Kuçi.

a) 3791 fermerë përfituan nga masa për tufën bazë të matrikullimit (gjedhë);

b) 5275 fermerë nga masa për tufën bazë të matrikullimit (të imta);

c) 4135 përfitues nga masa për mbarëshkrimin e bletarisë;

d) 1307 përfitues për fara, fidane dhe inpute të tjera bujqësore;

e) 751 përfitues për kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike;

f) 110 përfitues për fermat organike; 4 përfitues për certifikimin Global GAP;

g) 50.061 fermerë përfitues për naftën e përdorur në punimet e mekanizuara në bujqësi.

AZhBR bën të ditur se masa për naftën në bujqësi përbën numrin më të lartë të përfituesve, duke reflektuar rëndësinë e mbështetjes për uljen e kostove të mekanizimit dhe përmirësimin e eficiencës në prodhim.

Skema Kombëtare e Mbështetjes 2025 konsiderohet një ndër instrumentet kryesore të politikave publike në mbështetje të fermerëve, me synim rritjen e prodhimit vendas, formalizimin e sektorit dhe përmirësimin e standardeve në përputhje me kërkesat e tregut.



kontribuar në uljen e kostove të prodhimit, rritjen e konkurrueshmërisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të bujqë-

Sipas të dhënave të bëra publike nga AZhBR, numri i përfituesve sipas masave mbështetëse është:

## BASHKËPUNIM PËR RRITJEN E KREDITIMIT NË BUJQËSI

# KREDI ME 2% INTERES DHE 70% KOLATERAL TË MBULUAR - KUSH PËRFITON NGA INSTRUMENTI I GARANCISË SOVRANE NË BUJQËSI?

Nën drejtimin e Ministrit të Financave, Petrit Malaj, me pjesëmarrjen e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, si dhe Drejtorëve të Përgjithshëm të bankave tregtare që operojnë në vend dhe përfaqësuesve nga Shoqata Shqiptare e Bankave, u diskutua mbi financimin e bujqësisë. Skema e Garancisë sovraane për bujqësinë, për herë të parë, mbështet drejtpërdrejt fermerët dhe ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin bujqësor dhe agropërpunues, me një fond prej 3 miliardë lekësh (30 milionë euro)

Fermerëve dhe agrobizneseve të cilët kanë një plan investimi në bujqësi, blegtori, agropërpunim, mekanizimin e bujqësisë, turizëm rural dhe akuakulturë detare, u jepet mundësia për të aplikuar pranë bankave të nivelit të dytë për Kredi të butë me normë interesi 2% si dhe Garanci Sovraane me 70% kolateral të mbuluar.

Garancia Sovraane me fond prej 3 miliardë lekësh, ose 30 milionë euro është një instrument i cili është vendosur në shërbim të sektorit privat me qëllim lehtësimin e aksesit në financë për fermerët dhe Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme.

Synimi i këtyre instrumenteve është akses më i lartë financiar me fokus investimet

që rrisin kapacitetin dhe cilësinë prodhuese në aktivitetet bujqësore.

Qeveria shqiptare ka lidhur marrëveshje me 11 banka tregtare në vend për të bërë të mundur aplikimin e garancisë sovraane në sektorin bujqësor.

Garancia stimulon huadhënien nga bankat për ti mundësuar ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin e bujqësisë si dhe fermerëve të pajisur me NPT, investime për asete fizike dhe teknologjike që rritin kapacitetet prodhuese, cilësinë e prodhimit dhe eficiencën operationale të tyre.

Sipas marrëveshjes, qeveria merr përsipër të paguajë 70% të huasë së marrë nga bankat në rastin kur nuk shlyhet nga huamarrësi, por nuk merr përsipër

garantimin e interesave, kamatëvonesave dhe penaltiteteve apo çdo lloj detyrimi tjetër monetar që buron nga huatë.



Referuar marrëveshjes, totali i kredive të dhëna nga bankat për një huamarrës nuk duhet të kalojë vlerën prej 250 mijë euro dhe afati i kredisë nuk mund të jetë më i ulët se tre vjet dhe më i lartë se 5 vjet. Që të kualifikohen për kredi,

subjektet duhet të plotësojnë disa kriteret të përcaktuara në marrëveshje.

Konkretisht, aplikanti duhet të jetë subjekt që zhvillon aktivitetin si ndërmarrje mikro, e vogël, e mesme apo fermer me nipt aktiv; të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit; nuk duhet të ketë detyrime të papaguara në momentin e aplikimit; nuk duhet të ketë kredi me probleme; përfaqësuesi i subjektit nuk duhet të jetë gjykuar me vendim të formës së prerë për mashtrim, korrupsion përfshirje në një organizatë kriminale apo çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme që dëmton interesat financiare të fondeve publike si dhe nuk duhet të ketë detyrime në historik dhe në momentin ak-

tual ndaj Ministrisë së Financave që rrjedhin nga skema të mëparshme të garancive shtetërore.

## Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët

Të jetë ndërmarrje mikro, e vogël, e mesme, apo fermer me nipt aktiv

Të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit

Nuk duhet të ketë detyrime të papaguara në momentin e aplikimit

Përfaqësuesi i subjektit nuk duhet të jetë gjykuar me vendim të formës së prerë

Nuk duhet të ketë detyrime në historik dhe në momentin aktual.

## Garancia sovraane në bujqësi, interes të ulët - Financat, Bujqësia dhe BSH, takim me bankat: Orientoni fermerët drejt skemës

Disa muaj pas hapjes së dritës jeshile të garancinë sovraane në bujqësi, ka nisur dhe interesi i biznese agropërpunuese për të përfituar nga kjo skemë me qëllim kryerjen e investimeve për të cilat kanë nevojë. Por duke qenë se deri më tani aksesi ka qenë i ulët dhe me qëllim evidentimin e problematikave dhe marrjen e masave përkatëse, u zhvillua një takim gjithëpërfshirës midis Ministrit të Financave Petrit Malaj, Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë Gent Sejko, Ministrit të Bujqësisë Andis Salla, si dhe Drejtorëve të Përgjithshëm të bankave tregtare që operojnë në vend dhe Shoqatës Shqiptare të Bankave.

Ministri i Financave, Petrit Malaj, theksoi se sektori bujqësor mbetet një prioritet strategjik i Qeverisë së Shqipërisë. Sipas tij, me afrimin e integritit të ekonomisë shqiptare në tregun e përbashkët evropian është e nevojshme që biznesi shqiptar të përmirësojë produktivitetin dhe të rrisë vlerën e shtuar përgjatë të gjithë zinxhirit prodhues. Ministri theksoi se Skema e Garancisë Sovraane duhet parë si një mundësi që përshpejton pikërisht këtë proces sa jetik aq edhe imediat.

Guvernatori Gent Sejko, nga ana e tij theksoi nevojën për adresimin e disa çështjeve

operationale, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe përthithjes së saj. Në këtë kontekst, ai theksoi rëndësinë e koordinimit të vazhdueshëm ndërmjet autoriteteve publike, sektorit bankar dhe institucioneve të tjera të përfshira, për të siguruar që Skema të vijojë të jetë në linjë me objektivat strategjike të politikave financiare dhe të kontribuojë në një rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të kreditimit.

Nga ana e tij, Ministri i Bujqësisë Andis Salla, u shpreh se Skema e Garancisë ka filluar të shfaqë efektet e para, pas një periudhe ku fermerët kishin nevojë të njiheshin me të.

Sipas tij, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, së bashku me agjencitë e saj të varësisë, do vazhdojnë të bashkëpunojnë me fermerët për informim dhe asistencë gjatë procesit të aplikimit.

Pjesëmarrësit u bënë thirrje bankave që të intensifikojnë përpjekjet për orientimin e fermerëve drejt mundësive të pashfrytëzuara të financimit dhe investimit në sektorin bujqësor. Në këtë kontekst, autoritetet publike bëjnë thirrje që bizneset dhe fermerët të orientohen drejt mundësive të pashfrytëzuara të financimit, duke përfituar nga programet dhe skemat ekzistuese, për të zhvilluar aktivitetet e tyre dhe

për të kontribuar në rritjen e qëndrueshme ekonomike të vendit.

### Intensifikohet bashkëpunimi për rritjen e kreditimit në bujqësi

MBZHR dhe agjencitë e saj të varësisë do vazhdojnë të bashkëpunojnë me fermerët për informimin e tyre dhe për t'i asistuar ata përgjatë procesit të aplikimit për të përfituar kredi me interes të ulët dhe kolateral Garancinë Sovraane. Rritja e këtij bashkëpunimi trepalësh mes agjencive publike, bankave dhe fermerëve po krijon mundësi për të njohur dhe hulumtuar më tej potencialin zhvillimor të sektorit.

Drejtimesit e sektorit bankar gjate takimit me përfaqësuesit e BSH, MBZHR, MF dhe aktoreve të fushës, ndanë përshpikjet e tyre për ecurinë e dy skemave. Ata ranë dakord që pas një periudhe njohje, për sipërmarrësit dhe për bankat, muajt e fundit kanë treguar një gjallërim të skemës. Për më tepër, sipas të dhënave të brendshme, bankat konfirmojnë se një sërë aplikimesh të tjera janë aktualisht në proces vlerësimi.

Nga ana e sektorit bankar u ofruan disa opinione mbi ndërhyrje të ndryshme që mund të

ndërmerren në të ardhmen me synim rritjen e efikasitetit të përdorimit të skemave. Ministri dhe Guvernatori u angazhuan për vlerësim serioz të këtyre opinioneve dhe vazhdimin e diskutimit në takimet e ardhshme.

Pjesëmarrësit u bënë thirrje bankave që të intensifikojnë përpjekjet për orientimin e fermerëve drejt mundësive të pashfrytëzuara të financimit dhe investimit në sektorin bujqësor. Në këtë kontekst, autoritetet publike bëjnë thirrje që bizneset dhe fermerët të orientohen drejt mundësive të pashfrytëzuara të financimit, duke përfituar nga programet dhe skemat ekzistuese, për të zhvilluar aktivitetet e tyre dhe për të kontribuar në rritjen e qëndrueshme ekonomike të vendit.

Institucionet pjesëmarrëse riafirmuan angazhimin e tyre për bashkëpunim të ngushtë dhe të qëndrueshëm, në funksion të rritjes së aksesit në financim, nxitjes së investimeve dhe mbështetjes së zhvillimit ekonomik, me fokus të veçantë sektorin e bujqësisë dhe ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme.

Skema e Garancisë sovraane për bujqësinë, për herë të parë, mbështet drejtpërdrejt fermerët dhe ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme në sektorin bu-

jqësor dhe agropërpunues, me një fond prej 3 miliardë lekësh (30 milionë euro).

Garancia Sovraane mbulon deri në 70% të vlerës së kredisë, me normë interesi të kufizuar në 2%, periudhë grace minimale 12 muaj dhe pa penaltete për shlyerje të parakohshme.

### Kufizimet mbi normën e interesit e bëjnë skemën joefikase

Megjithatë qeveria dhe Banka e Shqipërisë janë përpjekur ta paraqitin këtë program si një shans për kreditimin e bujqësisë dhe të biznesit të vogël në tërësi, ekspertët e sektorit bankar shprehën se është e pamundur që një program me kufizime të tilla në normat e interesit t'i shërbejë realisht kreditimit të fermerëve dhe biznesit të vogël. Sipas tyre, kostot e riskut, kostot operationale dhe ato logjistike veçanërisht në sektorin e bujqësisë janë shumë të larta.

Likuiditeti i vënë në dispozicion nga Banka e Shqipërisë për bankat, në kuadër të programit, ka një normë interesi vjetore prej 0.5%. Sektori bankar mund të japë kredi për SME-të në kuadër të këtij programi me një normë interesi vjetore jo më të madhe se 3.5% në vit.

Megjithatë, norma e interesit duhet të jetë më e ulët, nëse programi kombinohet me skemën e garancisë sovraane të ofruar nga qeveria shqiptare. Në rastin kur garancia mbulon 15% - 35% të rrezikut të kredisë, interesi nuk mund të jetë më i lartë se 3%. Në rast se garancia sovraane mbulon 35% - 55% të rrezikut të kredisë, interesi maksimal do të jetë 2.5%. Në rast se garancia sovraane mbulon 55% - 75% të rrezikut të kreditit, norma tavan e interesit do të jetë 2%.

Bankierët shprehën se këto marzhe interesi nuk mund të mbulojnë kostot dhe aq më pak ta bëjnë produktin fitimprurës për bankat. Në këto kushte, asnjë institucion financiar nuk do të kishte interes të kreditonte fermerët e vegjël me një çmim të tillë. Madje edhe në rastin kur risku i kredisë do të mbulohej pjesërisht me një skemë garancie, kostot e tjera ngelen aq të larta, sa është pothuajse e pamundur që një normë e tillë e interesi të jetë e leverdisshme për një institucion financiar. Ekspertët mendojnë që programi i SME-ve mund t'u shërbejë ndoshta sipërmarrjeve të mëdha agropërpunuese, por vështirë se do të sjellë ndonjë dobi për fermerët e vegjël apo për biznesin e vogël, në përgjithësi.

## SIGURI USHQIMORE

## Salla: Mbështetje rekord për bujqësinë gjatë këtij viti

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, zhvilloi një takim dëgjese me fermerët e Dibrës, Klosit, Mat-

Ministri Salla theksoi se viti 2026 do të shënojë një mbështetje rekord për bujqësinë, e cila do të jetë plotësisht

deri në 70 për qind dhe kompensimit të TVSH-së për të gjithë fermerët, për çdo produkt të shitur nga 1 janari 2026 e në vijim.

Sipas ministrit, dëgjesat me fermerët janë thelbësore për ndërtimin e një panorame të qartë mbi sfidat dhe potencialët e bujqësisë, në funksion të një skeme sa më efektive dhe gjithëpërfshirëse.

Më herët, ministri Salla, së bashku me deputetën e PS, Ogerta Manastirliu, zhvilloi një takim në Baldushk me fermerët e qarkut Tiranë. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi sugjerimet dhe nevojat e fermerëve për adresimin dhe përdorimin sa më efikas të mbështetjes financiare.

Ministri vuri në dukje se Skema Kombëtare 2026 po hartohet mbi bazën e kontributit të drejtpërdrejtë të fermerëve, me synim rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve "Made in Albania" dhe ndërtimin e një bujqësie më të qëndrueshme, në përputhje me vizionin afatgjatë "Bujqësia 2030".



it dhe Bulqizës, në kuadër të hartimit të Skemës Kombëtare 2026.

Gjatë bashkëbisedimit, fermerët parashtruan sugjerimet dhe nevojat e tyre konkrete, me synim orientimin e mbështetjes financiare drejt sektorëve ku nevoja është më e madhe.

në dispozicion të fermerëve, por do të kërkojë angazhim, aplikim dhe bashkëpunim në grupe, si pjesë e procesit të formalizimit të sektorit.

Ai bëri të ditur se mbështetja do të realizohet përmes subvencioneve direkte, skemave të granteve, garancisë shtetërore

## Malaj: Bujqësia sektor prioritar, subvencione direkte fermerëve dhe rimbursim të TVSH-së

Ministri i Financave, Petrit Malaj deklaroi se në muajin shtator do të nisë projekti IP-ARD 3 ku janë edhe 118 milionë euro të tjera për sektorin e bujqësisë.

Në fjalën e tij në takimin me fermerët në Divjakë për Skemën Kombëtare 2026, ku është i pranishëm edhe kryeministri Edi Rama, Malaj tha se bujqësia konsiderohet nga Qeveria si sektor prioritar.

"Shifrat tregojnë realitetin dhe seriozitetin që ka kjo qeveri në lidhje me sektorin e bujqësisë. Në vitin 2013 kur morëm drejtimin e këtij vendi kemi marrë një buxhet me buxhet 34 milionë euro, e kemi mbyllur 2025 me një buxhet 162 milionë euro, pesëfishi i asaj që morëm. Kemi marrë një buxhet, e cila i kishte eksportet rreth 120 milionë euro, e cila sot në terma eksporti është mbi 500 milionë euro", theksoi Malaj.

Malaj vuri në dukje se "kemi

marrë një buxhet që kishte në sipërfaqe serrash 700 ha ndërsa sot janë trefishuar sipërfaqet e serrave mbi 2200 ha. Kemi marrë një buxhet ku toka e ujitur ishte 120 mijë ha dhe këtë vit do shkojmë në 300 mijë ha nga 360 mijë ha që është sipërfaqja e tokës së ujit në territor".

Në këtë mandat, vijoi Malaj, qeveria është e angazhuar që të ndërtojë një model, i cili synon të mbështesë drejtpërdrejt fermerët.

"Ky është një model që është i ngritur në 4 komponentë kryesorë".

Ai renditi skemën e granteve ku për 2026 janë parashikuar 20 milionë euro, skemën e subvencioneve direkte për fermerët që është 31 milionë euro e buxhetuar për 2026 si dhe garancinë sovranë dhe rimbursimin e TVSH-së.

"Kemi të hapur garancinë sovranë që iu mundëson të gjithë fermerëve kredi të buta me

normë interesi 2% dhe me garanci nga shteti për rreth 70% të vlerës së kredisë. Janë 30 milionë euro për vitin 2026. Ajo që është më e rëndësishme është kompensimi i TVSH për të gjithë fermerët, për çdo produkt që keni filluar të shisni nga data 1 janar 2026 e në vazhdim. Duhet të mbledhni faturat për produktet që çoni tek grumbulluesit dy herë në vit më 30 qershor dhe në 1 janar do të çoni faturat pranë autoriteteve tatimore dhe do të kompensoheni me 10% të vlerës së faturave", theksoi Malaj.

"Nga ana tjetër jemi besimplotë dhe shpresëplotë që në shtator do të hapet edhe IPARD3 dhe janë 118 milionë euro të tjera për sektorin e bujqësisë", tha Malaj.

Ministri Malaj u shpreh se "bujqësia ka nevojë për më shumë dhe jemi në rrugën e duhur për ta çuar atë në nivel tjetër dhe për ta pasur konkurruese në tregjet evropiane".

## INSTAT - Kriza e blegtorisë, importet e bulmetit u rritën me 62% ndërmjet 2021-2025

Blegtorët shqiptarë po e gjejnë veten të pafuqishëm për të konkurruar me prodhuesit e huaj, të cilët mbështeten nga skema subvencionimi dhe teknologji më efektive

Bilanci tregtar i Shqipërisë për produktet e shportës po dëshmon një varësi gjithnjë e më të theksuar nga importet jashtë vendit. Sipas të dhënave të INSTAT nga tregtia e jashtme, kategoria "Produkte bulmetore, vezët dhe mjalti" ka pësuar një rritje të fortë të vlerës së importit, duke u

ngjitur nga 6.8 miliardë lekë në vitin 2024, në rreth 7.7 miliardë lekë në vitin 2025.

Ky zgjerim prej rreth 14% brenda një viti kalendarik dhe 62% që nga viti 2021, po tregon se prodhimi vendas po humbet terren me shpejtësi përballë produkteve që vijnë kryesisht nga vendet e Rajonit dhe Bashkimit Evropian.

Kjo rritje e importeve vjen si pasojë e drejtpërdrejtë e një krize strukturore që ka mbërthyer sektorin e blegtorisë në Shqipëri. Prej vitesh, numri i krerëve në blegtori po pëson rënie sistematike, e nxitur nga braktisja e fshatit, plakja e popullsisë rurale dhe mungesa e interesit të rinjve për të trashëguar feramat familjare.

## Laborator i ri për analizën e mbetjeve në bujqësi, bashkëpunim UBT-AKUK

Me qëllim menaxhimin e qëndrueshëm të llumit (biosolide) në bujqësi dhe forcimin

financiare.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, do të ngrihet një lab-



e kapaciteteve kombëtare të analizës dhe monitorimit, Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) dhe Agjencia Kombëtare për Ujësjetës-Kanalizime (AKUK) kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi për ngritjen e një laboratorit të specializuar për analizat e llumit pranë UBT-së.

Marrëveshja u firmos nga Rektori i UBT-së, Fatbardh Sallaku, dhe Zv/Drejtorja e Përgjithshme e AKUK, Elidjana Çelaj, ndërsa ky bashkëpunim mbështetet nga GIZ, përmes asistencës teknike dhe

orator i specializuar, i cili do të shërbejë për analizimin, monitorimin dhe vlerësimin e llumit, duke mundësuar përdorimin e tij të sigurt dhe të qëndrueshëm në sektorin bujqësor, në përputhje me standardet mjedisore dhe bujqësore kombëtare dhe të Bashkimit Evropian.

Sipas palëve, laboratorit do të forcojë kapacitetet shkencore dhe teknike në nivel kombëtar dhe do të shërbejë si një strukturë referuese për institucionet publike, pushtetin vendor dhe operatorët e ujësjetës-kanalizimeve.

## Siguria ushqimore, Salla: Ngremë 7 pika të inspektimit kufitar, forcojmë AKU dhe ISU për kontrollin e import/eksporteve

Siguria ushqimore është një nga kapitujt që Shqipëria duhet të adresojë rekomandimet e Komisionit Evropian për të ecur para me procesin e negociatave në BE.

Gjatë mbledhjes së Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian, ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, tha se përmbushja e kërkesave të BE-së në këtë fushë është thelbësore për avancimin e vendit në rrugën drejt anëtarësimit dhe për mundësinë e përfshirjes dhe konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare në tregun evropian.

Një hap të rëndësishëm, ministri Salla nënvizoi përmirësimin e legjislacionit dhe ndërtimin e një sistemi kontrolli të njëjtë me atë të BE-së.

"Siguria ushqimore, veterinarja dhe kujdesi i bimëve janë elemente kyçe në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Evropian. Adresimi i kërkesave të BE-së për sigurinë ushqimore është thelbësor për përparimin në këtë proces. Harmonizimi i legjislacionit dhe ndërtimi i një kontrolli të barabartë me atë të BE-së, ku siguria ushqimore lidhet drejtpërdrejt me shëndetin, janë hapa të rëndësishëm për të mundësuar që prodhimi shqiptar të hyjë në tregun e BE-së dhe

të konkurrojë me standardet evropiane", tha ai.

Salla theksoi gjithashtu se do të investohen 20 milionë dollarësh për ndërtimin e 7 pikave inspektimi kufitar si dhe rritjen e kapaciteteve të institucioneve si Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) dhe Inspektorati i Shërbimeve Ushqimore (ISU), që janë të rëndësishme për menaxhimin e eksporteve dhe importeve ushqimore.

"Kemi përmirësuar kuadrin ligjor të gjithë sistemit, nga ferma në tavolinë, duke përfshirë përmirësimin e infrastrukturës mbështetëse, si laboratorët, forcimin e kontrolleve kufitare dhe sigurinë e pajisjeve të nevojshme për sigurinë ushqimore. Po bashkëpunojmë ngushtë me Gjermaninë për përmirësimin e cilësisë së produkteve shtazore. 20 milionë dollarë do të mbështesin ndërtimin e shtatë pikave inspektimi kufitar dhe rritjen e kapaciteteve të institucioneve si AKU dhe ISU, që janë të rëndësishme për eksportet dhe importet e produkteve ushqimore në vend", tha Salla.

Ministri përfundoi duke thënë se askush nuk mund të përballtet me sfidat e sigurisë ushqimore i vetëm, dhe se të gjithë duhet të angazhohen për ta bërë këtë një prioritet kombëtar.

Ky bashkëpunim mbështet Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Llumit 2025-2050, e cila synon menaxhimin e integruar të nënprodukteve të trajtimit të ujërave të ndotura reduktimin e ndikimit në mjedis dhe promovimin e praktikave të qëndrueshme në bujqësi.

Autoritetet vlerësuan se përfshirja e Universitetit Bujqësor të Tiranës në këtë proces forcon rolin e tij si qendër referencë shkencore, në shërbim të politikëbërjes publike, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të qëndrueshëm në Shqipëri.

Llumi në bujqësi është një nënprodukt organik që krijohet gjatë trajtimit të ujërave të ndotura (ujërat e zeza) ose të mbetjeve të tjera organike. Ai përmban: lëndë organike (materie bimore dhe kafshore e degraduar); ushqyes për bimët si azot, fosfor dhe kalium, si dhe mikroorganizma që ndihmojnë në dekompozim dhe fertilitet të tokës

Kur trajtohet dhe stabilizohet, llumi mund të përdoret në bujqësi si pleh organik, duke rritur pjellorinë e tokës dhe duke reduktuar nevojën për plehra kimikë. Në dokumente dhe rregullore evropiane, llumi i trajtuar quhet "biosolide".

"Investime të tjera dhe grante të vazhdueshme për sektorin publik dhe privat, si dhe bashkëpunimi me fermerët, do të ndihmojnë në rritjen e cilësisë dhe standardeve të tregut dhe sigurisë ushqimore. Askush nuk ia del dot vetëm në këtë proces; të gjithë duhet ta shohim këtë si një punë të përbashkët", tha ministri.

Edhe Drejtori Ekzekutiv i Lëvizjes Evropiane në Shqipëri, Gledis Gjipali, thekson se zbatimi i reformave ligjore kërkon përgatitje nga ekzekutivi qendror dhe lokal, duke përfshirë përmirësimin e legjislacionit, forcimin e strukturave dhe kapaciteteve.

"Nëse parlamenti duhet të vrapojë se i gjithë kjo sasi ligjesh do të duhet të zbatohet nga ekzekutivi dhe këtu ka rol si pushteti qendror dhe ai lokal. Me reformën për inspektoratet që është duke ndodhur do të ketë rëndësi të shtuar zbatimi i legjislacionit. Duhet përmirësuar legjislacioni, strukturat dhe të forcohen kapacitetet. Për pozicionet negociuese, grupe e interesit duhet të jenë të përfshira për të adresuar problematikat e terrenit në mënyrë që shpejtësia e procesit të mos ndikojë të cilësia e tij", tha Gjipali.

## POLITIKË FISKALE

# Hyn në fuqi udhëzimi, si do të funksionojë kompensimi 10% për TVSH-në e fermerëve

jetësit financiar nga blerësi.

Një nga ndryshimet kryesore lidhet me përcaktimin më të qartë të blerësve të produkteve bujqësore. Sipas udhëzimit të ri, si blerës të ligjshëm konsiderohen vetëm personat e regjistruar për TVSH që ushtrojnë aktivitet si grumbullues, përpunues të produkteve bujqësore apo struktura agroturizmi të certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për turizmin. Për herë të parë, agroturizmi i certifikuar përfshihet shprehimisht në skemë, duke zgjeruar rrethin e subjekteve që

mund të blejnë produkte nga fermerët përfitues.

Udhëzimi rikonfirmon se fermeri përfiton nga skema e kompensimit vetëm nëse qarkullimi i tij vjetor nuk tejkalon pragun minimal të regjistrimit për TVSH. Ky qarkullim llogaritet mbi vlerën totale të shitjeve të faturuara ndaj blerësve të regjistruar për TVSH që nuk përfitojnë vetë nga skema e kompensimit.

Ndryshim thelbësor është edhe mënyra e faturimit. Për çdo furnizim të produkteve bujqë-

sore, fatura tatimore fiskalizohet dhe lëshohet nga blerësi, në emër dhe për llogari të fermerit, me shënimin e detyrueshëm “Vetëfaturim sipas skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë”. Në këtë faturë nuk llogaritet TVSH, ndërsa evidentohet vlera e furnizimit mbi të cilën do të aplikohet norma e kompensimit.

Norma e kompensimit mbetet 10% dhe zbatohet mbi vlerën totale të faturave të lëshuara gjatë periudhës gjashtëmuajore për të cilën fermeri paraqet

kërkesë. Ndryshe nga skema e mëparshme, kompensimi nuk kryhet më nga blerësi përmes zbritjes së TVSH-së, por paguhet drejtpërdrejt nga administrata tatimore në llogarinë bankare të fermerit.

Kërkesat për kompensim do të dorëzohen dy herë në vit: deri më 31 dhjetor për furnizimet e periudhës janar–qershor dhe deri më 30 qershor të vitit pasardhës për furnizimet korrik–dhjetor. Administrata tatimore ka afat 30 ditë nga verifikimi i plotë i dokumen-

tacionit për të kryer pagesën e kompensimit.

Paralelisht, udhëzimi shfuqizon disa nene të mëparshme që lidhnin të drejtën e zbritjes së TVSH-së me blerësin, duke e zhvendosur tërësisht barrën e verifikimit dhe pagesës te administrata tatimore. Kjo pritet të reduktojë konfliktet mes fermerëve dhe blerësve, si dhe të rrisë transparencën dhe gjurmueshmërinë fiskale të transaksioneve bujqësore.

Në thelb, ndryshimet synojnë ta bëjnë skemën e kompensimit më të qartë, më të kontrollueshme dhe më të drejtë për fermerët e vegjël, duke forcuar njëkohësisht disiplinën fiskale në sektorin bujqësor dhe atë të agroturizmit.

## UDHËZIM

Nr. 4, datë 30.1.2026

### PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 3.11.2014, “PËR ZBATIMIN E REGJIMIT TË VEÇANTË TË SKEMËS SË KOMPENSIMIT TË PRODHUESVE BUJQËSORË PËR QËLLIME TË TATIMIT MBI VLERËN E SHTUAR”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 159, paragrafi 2, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

#### UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

#### Neni 1

Në nenin 3 “Kushte të përgjithshme”, pas pikës 1, shtohen pikat 1.1 dhe 1.2 me përmbajtjen si më poshtë:

“1.1 Personi i tatueshëm, blerës i produkteve bujqësore është personi i regjistruar për TVSH-në, i cili ushtron aktivitet si grumbullues ose/dhe përpunues i produkteve bujqësore apo agroturizëm i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për turizmin.

1.2 Për qëllime të këtij udhëzimi, blerësit e produkteve bujqësore, referuar pikës 1.1 të këtij neni, kanë kuptimin si më poshtë:

a) “Grumbullues i produkteve bujqësore” është personi fizik ose juridik, i regjistruar me përgjegjësi tatimore për TVSH-në, i cili ushtron veprimtari ekonomike, sipas kodeve të aneksit 1 bashkëlidhur, të blerjes, mbledhjes, selektimit dhe tregimit me shumicë, të produkteve bujqësore dhe/ose blegtorale, me prejardhje nga puna e fermerit, të furnizuara drejtpërdrejt prej tij;

b) “Përpunues i produkteve bujqësore” është personi fizik ose juridik, i regjistruar me përgjegjësi tatimore për TVSH-në, i cili ushtron veprimtari Viti 2026 – Numri 29 ekonomike, sipas kodeve të aneksit 1 bashkëlidhur, të blerjes dhe përpunimit të produkteve bujqësore dhe/ose blegtorale, me prejardhje nga puna e fermerit, të furnizuara drejtpërdrejt prej tij;

c) “Agroturizëm i certifikuar” ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për turizmin, ku personi i tatueshëm që ushtron këtë aktivitet blen produkte bujqësore dhe/ose blegtorale, me prejardhje nga puna e fermerit, të furnizuara drejtpërdrejt prej tij.”.

#### Neni 2

Në nenin 4 “Kushtet për të përfituar nga skema e kompensimit”, pika 1, riformulohet me përmbajtjen si më poshtë:

“Fermeri përfiton të drejtën e kompensimit për sa kohë që qarkullimi vjetor i tij nuk tejkalon kufirin minimal të përcaktuar të regjistrimit për TVSH-në. Ky qarkullim bazohet në shitjet e kryera, sipas vlerës totale të furnizimit të shënuar në faturë, për produktet bujqësore, kundrejt personave të tatueshëm që nuk përfitojnë nga skema e kompensimit, të regjistruar për TVSH-në që ushtrojnë aktivitet si grumbullues ose/dhe përpunues i produkteve bujqësore apo agroturizëm i certifikuar.”.

#### Neni 3

Në pikën 2, të nenit 7 “Çregjistrimi i fermerit”, shfuqizohet fjalia e fundit me përmbajtje: “Personi i tatueshëm që ka përfituar zbritjen e TVSH-së së shënuar në faturën e lëshuar në emrin dhe për llogari të fermerit të çregjistruar, pas datës që çregjistrimi i tij ka hyrë në fuqi, nuk i lejohet të zbrisë TVSH-në përkatëse dhe ndërkohë nëse e ka zbritur atë TVSH në shkelje të procedurës, i kërkohet të paguajë 100% TVSH-në e zbritur padrejtësisht.”.

#### Neni 4

Neni 8 “Mënyra e zbatimit të skemës së kompensimit” ndryshon me

përmbajtjen si më poshtë:

“Neni 8 Mënyra e zbatimit të skemës së kompensimit

1. Blerësi, personi i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në, për çdo furnizim të produkteve Faqe|2471 Fletorja Zyrtare bujqësore, të marrë prej fermerit, në përputhje me këtë udhëzim, lëshon një faturë tatimore të fiskalizuar, në përputhje me ligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit, në të cilën evidenton si shitës, shitësin fermer (prodhues bujqësor), NIPT-in e fermerit dhe të dhënat e tjera të kërkuara sipas faturës. Kjo faturë, në të cilën nuk llogaritet TVSH-ja, lëshohet nga blerësi në momentin e dorëzimit të produkteve bujqësore nga fermeri.

2. Vlera e faturës përfaqëson vlerën e furnizimit të paguar nga blerësi për llogari të shitësit fermer, mbi të cilën aplikohet norma e kompensimit. Kjo vlerë e faturës regjistrohet nga blerësi i produkteve bujqësore në rubrikën e librit të blerjeve “Nga fermerët vendas/vlera e tatueshme”. Rubrika e librit të blerjeve “Nga fermerët vendas/TVSH” nuk plotësohet, pasi kompensimi i jepet fermerit nga administrata tatimore dhe jo nga blerësi.

3. Kërkesa për kompensim paraqitet sipas periudhave të mëposhtme:

- brenda datës 31 dhjetor, për furnizimet e kryera gjatë periudhës janar–qershor të vitit përkatës;
- brenda datës 30 qershor të vitit pasardhës, për furnizimet e kryera gjatë periudhës korrik–dhjetor të vitit paraardhës.

4. Fermeri, nëpërmjet shërbimit postar ose në rrugë elektronike, dorëzon në administratën tatimore kërkesën për kompensim, sipas formatit bashkëlidhur këtij udhëzimi. Kërkesa, ndër të tjera, duhet të përmbajë vlerën totale të faturave të lëshuara përgjatë periudhës së kompensimit, si dhe numrin e llogarisë bankare të fermerit. Kjo kërkesë shoqërohet edhe me kopje të faturave të lëshuara nga blerësi, sipas nenit 9 të këtij udhëzimi, të cilat duhet të jenë të firmosura nga shitësi-fermer.

5. Për të përfituar kompensimin, kushtet që duhet të plotësojë fermeri janë:

- qarkullimi vjetor nuk tejkalon kufirin minimal të regjistrimit për TVSH-në, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave;
- të ketë kryer furnizime të produkteve bujqësore, sipas nenit 2 të këtij udhëzimi;
- të ketë furnizuar persona të tatueshëm që nuk përfitojnë nga skema e kompensimit në Republikën e Shqipërisë, të cilët janë të regjistruar për TVSH-në dhe ushtrojnë aktivitet si grumbullues ose/dhe përpunues i produkteve bujqësore apo agroturizëm i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi për turizmin; Faqe|2472 Viti 2026 – Numri 29
- është pajisur me një numër identifikimi të personit të tatueshëm, sipas nenit 5 të këtij udhëzimi; e) faturat e marra nga blerësi, mbi bazën e së cilave kërkohet kompensimi janë të fiskalizuara dhe regjistruara në bazën e të dhënave të administratës tatimore qendrore.

6. Norma e kompensimit në masën 10% zbatohet mbi vlerën e faturës/ave tatimore që blerësi, personi i tatueshëm i ka lëshuar shitësit, prodhues bujqësor, përgjatë periudhës gjashtëmuajore, për të cilën kërkohet kompensimi.

7. Kompensimi ka për qëllim të mbulojë një pjesë të TVSH-së së paguar prej fermerëve në çmimin e blerjes së mallrave e shërbimeve, të blera për nevoja të kryerjes së aktivitetit të tyre prodhues bujqësor.

8. Pas marrjes së kërkesës për kompensim, administrata tatimore shqyrton kërkesën, kontrollon dhe vlerëson dokumentet bashkëlidhur, për të për-

caktuar nëse fermeri i plotëson kushtet për përfitimin e kompensimit ajo jo. Nëse konstatohen mangësi në dokumentacion, administrata tatimore njofton menjëherë fermerin për mangësitë e konstatuara dhe për plotësimin e tyre, brenda një afati 10-(dhjetë-)-ditor.

Administrata tatimore, krahas verifikimit të faturave të lëshuara nga blerësi, sipas nenit 9 të këtij udhëzimi dhe të firmosura nga shitësi-fermer, verifikon edhe nëse blerësi i produkteve bujqësore është personi i tatueshëm i regjistruar për TVSH-në që ushtron aktivitet si grumbullues ose/dhe përpunues i produkteve bujqësore apo agroturizëm i certifikuar, sipas kuptimit në nenin 3 të këtij udhëzimi. Gjithashtu, ajo verifikon përputhshmërinë e vlerës së produkteve bujqësore sipas faturave të dorëzuara nga fermeri me vlerën e faturave të fiskalizuara dhe deklaruar nga blerësi në bazën e të dhënave të administratës tatimore qendrore.

9. Nëse pas verifikimeve, rezulton se janë përmbushur kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në ligj dhe në këtë udhëzim, administrata tatimore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, paguan shumën e kompensimit direkt në llogarinë bankare të fermerit. Shuma që do të kompensohet është rezultat i shumëzimit të normës së kompensimit me vlerën totale të furnizimit të produkteve bujqësore, të kryer në periudhën përkatëse.”.

Fletorja Zyrtare Viti 2026 – Numri 29 Neni 5 Neni 9 “E drejta e zbritjes së TVSH-së së kompensuar” shfuqizohet. Neni 6 Neni 10 “Fatura tatimore dhe norma e kompensimit” numërohet neni 9 dhe ndryshon me përmbajtjen, si më poshtë:

“Neni 9 Fatura tatimore dhe norma e kompensimit

1. Fatura duhet të përmbajë dhe të plotësohet me të gjitha të dhënat e kërkuara sipas rubrikave përkatëse. Në çdo faturë të lëshuar nga blerësi, personi i tatueshëm, duhet të evidentohet shënimi “Vetëfaturim sipas skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë”.

2. Fatura tatimore e fiskalizuar e shitjes, e lëshuar nga personi i tatueshëm blerës për prodhuesin bujqësor (fermerin), duhet detyrimisht të përmbajë të shënuara të dhënat e mëposhtme:

- numri i faturës;
- numri i sigurisë së lëshuesit të faturës (NSLF);
- numri identifikues i veçantë i faturës (NIVF);
- data dhe ora e lëshimit të faturës;
- numri rendor që mundëson identifikimin e faturës;
- të dhënat e fermerit, si: emri, adresa ku ka veprimtarinë prodhuese, NIPT-i;
- të dhënat e blerësit, personit të tatueshëm, si: emri, adresa, kodi i vendit të ushtrimit të veprimtarisë, NIPT-i;
- përshkrimi, sasia dhe njësia matëse e mallrave;
- vlera e mallrave të blera pa TVSH.

3. Në rastin kur blerësi, personi i tatueshëm paraqitet në adresën e fermerit dhe transporton mallrat me mjetet e tij nga adresa e fermerit në adresën ku blerësi kryen veprimtarinë ekonomike, atëherë fatura tatimore i lëshohet fermerit nga blerësi në momentin që malli bëhet i disponueshëm prej blerësit dhe fatura shoqëron mallin në adresën e blerësit. Në këtë rast në faturë shënohen edhe të dhënat e transportuesit.”. Neni 7 Neni 11 “Deklarimi” shfuqizohet. Neni 8

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE  
Petrit Malaj

(Vijon në faqen 6)

POLITIKË FISKALE

# Hyn në fuqi udhëzimi, si do të funksionojë kompensimi 10% për TVSH-në e fermerëve

(Vijon nga faqja 5)

Tabelë 1

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

### KËRKESË PËR KOMPENSIM TË TVSH-së

Emri dhe mbiemri i fermerit: \_\_\_\_\_  
 NIPT-i: \_\_\_\_\_  
 Adresa: \_\_\_\_\_  
 Numri i telefonit: \_\_\_\_\_

Kërkoj shumën e kompensimit të TVSH-së, në zbatim të seksionit 4, kreu XI, të ligjit nr. 92/2014, i ndryshuar dhe udhëzimit të ministrit të Financave nr. 19, datë 3.11.2014, i ndryshuar.

Vlera totale e furnizimit të produkteve bujqësore, të kryer në:	Norma e kompensimit	Shuma e kompensimit	Numri i llogarisë bankare:
Periudha: _____/viti _____	10%	Shuma e kërkuar në lekë	_____
1	2	3= (1x2)	_____

(Nënshkrimi i fermerit) \_\_\_\_\_ (data) \_\_\_\_\_

Faqe | 2473


Tabelë 3

**2. Blegtoria:**

- mbarështimi i kafshëve;
- mbarështimi i shpendëve;
- mbarështimi i lepujve;
- mbarështimi i bletëve;
- mbarështimi i krimbit të mëndafshit;
- mbarështimi i kërmillit.

Faqe | 2474

---

Fletorja Zyrtare  Viti 2026 – Numri 29

Nr.	Përshkrimi	Kodi
1	Rritja e gjedhëve për qumësht	A141
2	Rritja e të tjera gjedhëve dhe buall	A142
3	Rritja e kuajve dhe njëthundrakëve	A143
4	Rritja e dheneve dhe dhive	A145
5	Rritja e derrave	A146
6	Rritja e shpendëve	A147
7	Rritja e kafshëve të tjera	A149
8	Tregtia me shumicë e mishit dhe produkteve të mishit	G4632
9	Tregtia me shumicë e produkteve bulmetore, vezëve, dhe vajit të gatimit dhe yndyrnave	G4633
10	Prodhimi dhe përpunimi i mishit	C1011
11	Prodhimi i produkteve të mishit dhe mishit të shpendëve	C1013
12	Përpunimi i produkteve të qumështit	C1051
13	Përpunimi i vajrave dhe yndyrnave	C1041
14	Aktivite ndihmëse për prodhimet blegtorale	A162

Tabelë 2

ANEKS 1  
LISTA E KODEVE TË VEPRIMTARIVE EKONOMIKE PËRFITUESE TË SKEMËS SË KOMPENSIMIT

- Kultura bujqësore:**
  - bujqësia e përgjithshme, përfshirë vreshtarinë;
  - pemëtaria (përfshirë olivokulturën) dhe hortikultura (perimet, lulet dhe bimët zbukuruese), edhe në serra;
  - prodhimi i kërpudhave dhe i erëzave, i farërave dhe filizave;
  - prodhimi i fidanëve.

Nr.	Përshkrimi	Kodi
1	Kultivimi i drithërave (përveç orizit), të bimëve bishtajore dhe farërave vajore	A111
2	Kultivimi i orizit	A112
3	Kultivimi i perimeve dhe pjepër e shalqi, rrënjore dhe tuberozë	A113
4	Kultivimi i duhanit	A115
5	Kultivimi i bimëve fibroze	A116
6	Kultivimi i bimëve të tjera joshumëvjeçare	A119
7	Kultivimi i hardhive	A121
8	Kultivimi i agrumeve	A123
9	Kultivimi i frutave me bërthame dhe frutave me farë	A124
10	Rritja e të tjera pemëve e shkurreve frutore dhe e frutave te thata	A125
11	Rritja e frutave vajore	A126
12	Kultivimi i kulturave për pije	A127
13	Kultivimi i erëzave, bimëve aromatike, farmaceutike dhe mjekësore	A128
14	Kultivimi i bimëve të tjera shumëvjeçare	A129
15	Shumimi i bimëve	A130
16	Ferma mikse	A150
17	Aktivite ndihmëse për prodhimin bimor	A161
18	Përpunimi i farërave për shumim	A164
19	Mbledhja e produkteve pyjore të egra jodrusore rritur në natyrë	A230
20	Tregtia me shumicë e drithërave, duhanit të papërpunuar, farërave dhe ushqimit të kafshëve	G4621
21	Tregtia me shumicë e luleve dhe bimëve	G4622
22	Tregtia me shumicë e kafshëve	G4623
23	Tregtia me shumicë e frutave dhe perimeve	G4631
24	Tregtia me shumicë e produkteve të duhanit	G4635
25	Tregtia me shumicë e kafes, çajit, kakaos dhe erëzave	G4637
26	Tregtia me shumicë jo e specializuar e artikujve ushqimorë, pije dhe duhan	G4639
27	Tregtia me shumicë e produkteve të tjera ndërmjetëse	G4676
28	Tregtia me shumicë jo e specializuar	G4690
29	Përpunimi i lëngut të frutave dhe perimeve	C1032
30	Procese të tjera përpunimi dhe konservimi të frutave dhe perimeve	C1039
31	Përpunimi i produkteve të drithërave	C1061
32	Prodhimi i bukës, prodhimi pastave të freskëta dhe kekëve	C1071
33	Distilimi, rektifikimi dhe kombinimi i pijeve	C1101
34	Prodhimi i verës nga rrushi	C1102
35	Prodhimi i mushtit dhe verërave të tjera me bazë frutash	C1103
36	Prodhimi i birrës	C1105
37	Prodhimin e pijeve të tavolinës, prodhimi i ujit mineral dhe ujërave të tjerë në shishe	C1107
38	Përpunimi i vajrave esenciale	C2053
39	Prodhimi i produkteve të tjera ushqimore p.k.t	C1089

## Salla dhe Kumbaro në dialog me fermerët e Gjirokastrës: Mbështetje për blegtorinë si shtyllë kryesore e ekonomisë së zonës

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, së bashku me ministren e Arsimit dhe njëkohësisht drejtuese politike të qarkut të Gjirokastrës,

Mirela Kumbaro Furxhi, zhvilluan një takim të hapur me fermerët e Gjirokastrës, Tepelenës, Këlcyrës, Memaliajt, Dropullit, Përmetit dhe Libohovës.

ishte sektori i blegtorisë, i cili mbetet shtylla kryesore e ekonomisë së zonës. Fermerët ndanë nevojat e tyre reale për mbështetje, ndërsa u evidencuar për vitin 2026 është planifikuar një mbështetje e lartë për bujqësinë, me një fond prej 119 milionë eurosh, që do të mundësojë investime për prodhimin e produkteve konkurruese në tregjet europiane. Mbështetja do të realizohet përmes një kombinimi instrumentesh financiare: subvencione direkte, skema grantesh dhe garanci shtetërore deri në 70%, duke synuar rritjen e prodhimit, zhvillimin e sipërmarrjeve bujqësore dhe forcimin e qëndrueshmërisë së ekonomisë rurale.

Fermerët e pranishëm theksuan rëndësinë e investimeve në blegtori si faktor kyç për zhvillimin e zonës dhe krijimin e mundësive të reja ekonomike, duke e parë këtë mbështetje si një hap të rëndësishëm drejt fuqizimit të komuniteteve rurale.

tuan potencialet prodhuese të rajonit dhe mënyrat se si ato mund të fuqizohen përmes Skemës Kombëtare 2026, e ndërtuar mbi përvojën e terrenit dhe kërkesat e vetë fermerëve. Ministri Salla theksoi se



## Miratohet marrëveshja Interreg Europe, Shqipëria përfiton fond për bujqësinë dhe agroturizmin

Komisioni për Bujqësinë, Ushqimin dhe Zhvillimin Rural miratoi projektligjin për ratifikimin e marrëveshjes për programin Interreg Europe 2021–2027 mes Shqipërisë, Francës dhe Komisionit Evropian.

“Zona gjeografike është përcaktuar nga Komisioni Evropian, në momentin kur është bërë programi i IPA 2, institucionet shqiptare insistojnë që ta zgjerojnë në këtë zonë gjeografike, ku do jetë Dibra që të përfshihet dhe Kosova, por edhe Shkodra”, tha Drejtori i Konvergjencës dhe Kohezionit, Klajdi Demko.

Drejtori i Konvergjencës dhe Kohezionit, Klajdi Demko, tha se marrëveshja i hap rrugë Shqipërisë për të përfitur fonde IPA për projekte bashkëpunimi ndër rajonal dhe shkëmbim praktikash evropiane. Sipas tij, deri tani 38 institucione publike shqiptare janë përfshirë në projekte Interreg Europe me një vlerë to-

tale 3.7 milionë euro.

“Për herë të parë po bëhemi pjesë e këtij programi dhe po hartojmë dhe zbatojmë projekte

ane, veçanërisht në sektorë si bujqësia dhe agroturizmi.

“Për Shqipërinë pjesëmarrja në këtë program përfaqëson



të përbashkëta me Gjermaninë, Francën dhe po adresojmë sfidat e përbashkëta. Përfituesit e këtij programi janë 38 institucione publike shqiptare”, tha Demko.

Relatori i projektligjit, deputeti Orinaldo Rakipi, theksoi se ky ligj forcon bazën ligjore për përfitimin e projekteve evropi-

një mundësi për të përfitur nga përvojat më të mira evropiane dhe t'i sjellim ato në kontekstin e politikave vendore”, tha Rakipi.

Programi Interreg Europe ka një buxhet total prej 493 milionë eurosh dhe Shqipëria pritet të përfitojë rreth 2 milionë euro gjatë periudhës së zbatimit.

## Shqipëri-Kosovë, bashkëpunim doganor në shërbim të tregtisë dhe bizneseve

Drejtori i përgjithshëm i Doganës Shqiptare, Besmir Beja priti në një takim drejtorin e Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, takimi i parë zyrtar i Drejtorit të Përgjithshëm që prej marrjes së detyrës.

Në një njoftim, Dogana Shqiptare bën me dije se gjatë bashkëpunimit u vlerësuan marrëdhëniet shumë të mira dhe bashkëpunimi i qëndrueshëm ndër vite mes dy administratave doganore, me rezultate konkrete në lehtësimin e procedurave dhe rritjen e shkëmbimeve tregtare.

Prezenca e Doganës së Kosovës në Portin e Durrësit dhe funksionimi i pikës unike One Stop Shop në Morinë janë cilësuar si vlera të shtuara për ekonominë e të dy vendeve, duke kursyer kohë dhe kosto për bizneset dhe duke rritur fluksin e mallrave dhe pasagjerëve.

Drejtori i Doganës së Kosovës theksoi se hapja e Zyrës Doganore në Portin e Durrësit për

për thjeshtimin e procedurave, rritjen e transparencës dhe përmirësimin e shërbimit ndaj



faqëson një arritje të rëndësishme për ekonominë e Kosovës, duke krijuar lehtësi reale për operatorët ekonomikë dhe duke rritur konkurrueshmërinë e tyre.

Nga ana e tij, Drejtori i Përgjithshëm i Doganës Shqiptare e vuri theksin te proceset e digitalizimit, si një element kyç

bizneseve, si dhe te bashkëpunimi në hetimet e përbashkëta dhe lufta kundër paligjshmërisë.

Takimi rikonfirmoi angazhimin e përbashkët për forcimin e bashkëpunimit doganor në funksion të lehtësimit të tregtisë, sigurisë dhe zhvillimit ekonomik të dy vendeve.

## Malaj diskuton me BB zgjerimin e portofolit investues në turizëm

Ministri i Financave, Petrit Malaj priti në një takim drejtorin Global të Grupit të Bankës Botërore për Zhvillimin Urban, Financat Vendore, Turizmin dhe Menaxhimin e Fatkeqë-

sive, Ming Zhang, si dhe ekipin e Turizmit (PIUTD), ku u diskutua mbi potencialin e bashkëpunimit në fushën e turizmit. "Diskutuam për zgjerimin e portofolit investues,

mbështetjen për projektet prioritare dhe rolin kyç të turizmit në rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës dhe zhvillimin e qëndrueshëm", tha Malaj.

Malaj vlerësoi se partneriteti me Grupin e Bankës Botërore mbetet thelbësor për të orientuar investimet drejt projekteve me ndikim afatgjatë dhe për të forcuar kapacitetet institucionale.

"Angazhimi ynë është i qartë: të shfrytëzojmë potencialin e plotë të turizmit shqiptar, duke e kthyer atë në një motor të qëndrueshëm zhvillimi dhe mirëqenieje për vendin", deklaroi ai.



## Moti me lagështi, kalbet gruri dhe elbi në fushat e Maliqit! Specialistët kërkojnë mirëmbajtjen e kanaleve kulluese

*Lagështia nga reshjet e vazhdueshme po dëmton grurin dhe elbin në Maliq, duke ulur rendimentin dhe rritur rrezikun e sëmundjeve tek bimët. Specialisti Përparim Kuqo thotë se është urgjente mirëmbajtja e kanaleve kulluese*

Reshjet e shumta të kohëve të fundit kanë sjellë probleme serioze për kulturat bujqësore, veçanërisht për grurin dhe elbin, ku lagështia e tepërt e tokës po konsiderohet një ndër faktorët kryesorë në rënien e prodhimit.

Sipas specialistëve të bujqësisë, kullimi është kusht thelbësor për zhvillimin normal të këtyre kulturave. Temperatura e ujit dëmton rrënjët, ul aktivitetin mikrobiologjik të tokës, prish strukturën e saj dhe rrit rrezikun e sëmundjeve tek bimët.

Situata paraqitet më e rënduar në bashkinë e Maliqit, ku ka ende sipërfaqe të konsiderueshme të mbuluara me ujë. Edhe në Qendrën e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore raportohen rreth 2 hektarë nën ujë, pavarësisht masave të marra.

Specialistët kërkojnë hapjen urgjente dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të kanaleve kulluese, si dhe plehërim plotësues nga fermerët.

"Kjo shkakton dëme të mëdha të te këto kultura. Rrënjët dalin në sipërfaqe, ulet ak-

tiviteti mikrobiologjik i tokës, prishet struktura e tokës nga ngjeshja dhe prania e ujit.

Është e domosdoshme të merren masa për kullimin. Duhet të hapen kanalet kulluese. Këto kanale kulluese duhet të jenë në gatishmëri", tha Përparim Kuqo, specialist pranë qendrës së transferimit të teknologjive bujqësore.

Rendimenti i këtij viti pritet të jetë i kufizuar, sidomos në parcelat që kanë mbajtur lagështirë për një kohë të gjatë, me ndikim më të theksuar në zonën e Maliqit.

## Toka bujqësore në rrethinat e Tiranës kushton deri në 100 euro/m<sup>2</sup>, rreth 70 herë mbi mesataren e BE

Nëse në Farkë rreth 3 vite më parë toka bujqësore shitej me çmim 50 euro për metër katror, aktualisht çmimi ka arritur nga 70 euro deri në 100 euro për metër katror.

Sipas të dhënave nga tregu, çmimi i tokës është dyfishuar.

shumica e saj shfrytëzohet për ndërtim, dhe madje nuk ka më hapësira të gjelbra të lira në këto zona. Zonja Dhami nënvizon se edhe vetë pronarët nuk janë të interesuar të ulin çmimin e shitjes së tokës bujqësore, dhe shumë prej tyre preferojnë

për metër katror arriti në 1.5 euro për metër katror).

Sipas të dhënave të sponueshme, shtetet me çmimin më të lartë mesatar për 1 hektar tokë bujqësore është Malta me 201,263 euro, pasuar nga Holanda me 96,608 euro dhe Portugalia me 76,556 euro. Ndërkaq, çmimet më të ulëta janë regjistruar në Letoni (4,825 euro), Lituani (5,590 euro) dhe Sllovakia (5,823 euro).

Referuar tabelave të detajuara publikuar nga Eurostat, pas Maltës, një ndër zonat më të shtrenjta për tokën bujqësore është Flevoland të Hollandës. Çmimi i tokës bujqësore në këtë zonë në 2024 arriti 187 mijë euro për hektar.

Flevoland është zona kryesore bujqësore me tokë të re, shumë pjellore dhe të shtruar afër detit dhe kjo e bën çmimin e tokës atje shumë të lartë krahasuar me pjesën tjetër të Hollandës.

Çmimi i larta shitjeje, ofrohen edhe në ishujt Kanarias të Spanjës çmimi ka arritur 148 mijë euro për ha, sipas të dhënave të Eurostat për 2024.

Në vendet e rajonit çmimet e tokës bujqësore janë më të ulëta. Në Selanik të Greqisë çmimi i tokës bujqësore është 14,600 euro për ha apo rreth 1.5 euro për metër katror.

"Monitor"



Në rrethina të tjera të Tiranës, sipas agjentëve imobiliarë, si fshati Mullet apo Ndroq çmimi i tokës bujqësore është mbi 50 euro për metër katror.

Nëse do të blihet 1 hektar (ha) tokë këto në këto zona, vlera do të kushtojë nga 500 mijë deri 700 mijë euro deri në 1 milion euro vlera maksimale në Farkë.

Sipas Stela Dhami nga "Colliers International Albania" rritja e ndjeshme të çmimit të tokës bujqësore është sepse

ta menaxhojnë në mënyrë "të zgjuar" tokën bujqësore.

Krahasuar me vendet e Bashkimit Europian çmimet e tokës bujqësore në rrethinat e Tiranës kushtojnë shumë herë më shtrenjtë.

Në vendet e BE-së, sipas të dhënave të Eurostat, çmimi mesatar i tokës bujqësore për vitin 2024 arriti 15,224 euro për ha apo rreth 1.5 euro për metër katror. Krahasuar me 2023 çmimi i shitjes për tokën bujqësore në BE u rrit 6.1% (nga 1.4 euro

## Përshtatja me klimën, Shqipëria me përgatitjen më të dobët në rajon

*Fondacioni European për Trajnimet e vlerësoi Shqipërinë negativisht në përgatitjen e forcës punëtore për ekonominë e gjelbër. Sipas raportit, Shqipëria nuk është as në fazat e para të përgatitjes dhe në këtë mënyrë rrezikon t'i lërë punëtorët dhe komunitetet të papërgatitura për tranzicionin. Tranzicioni i gjelbër në dokumentet shqiptare konceptohet kryesisht si një proces mjedisor dhe teknik, jo si një transformim socio-ekonomik*

Shqipëria ka përgatitje në nivelin bazë dhe shumë më pas rajonit në përshtatjen e sistemit të saj arsimor dhe tregut të punës me tranzicionin e gjelbër.

Fondacioni European për Trajnimet që kujdeset për kapitalin njerëzor jashtë BE-së e vlerësoi Shqipërinë negativisht në përgatitjen e forcës punëtore për ekonominë e gjelbër.

Tranzicioni me karbon të ulët po riformëson ekonominë në të gjithë fqinjët e BE-së dhe Azinë Qendrore. Ndërsa sistemet e energjisë ndryshojnë, industrinë po përshtaten dhe komunitetet po përjetojnë ndryshime të thella në punë.

Raporti i Fondacionit European të Trajnimit "Fuqizimi i Tranzicionit të Drejtë në Fqinjët e BE-së dhe Azinë Qendrore" për 25 vende, mes tyre edhe Ballkani Perëndimor, vlerëson se Shqipëria nuk është as në fazat e para të përgatitjes dhe në këtë mënyrë rrezikon t'i lërë punëtorët dhe komunitetet të papërgatitura për tranzicionin.

Shqipëria rezulton pozitivisht vetëm në dy kriteret e para, që lidhen me njohjen e përgjithshme të ndikimeve sociale dhe të punësimit nga ndryshimet klimatike dhe me përmendjen e nevojave të reja apo në ndryshim të fuqisë punëtore për shkak të tranzicionit të gjelbër.

Dokumentet strategjike shqiptare e pranojnë në parim se tranzicioni klimatik ka pasojë sociale dhe kërkon përshtatje të tregut të punës, por nuk ka asnjë planifikim dhe zbatim praktik.

Në pothuajse të gjitha kriteret e tjera, Shqipëria vlerësohet negativisht. Analiza tregon se Shqipëria nuk i referohet nevojës për rikualifikim apo përmirësim aftësish të punëtorëve në sektorët që preken nga tranzicioni i gjelbër, nuk e trajton rolin e arsimit dhe zhvillimit të aftësive si instrument për parashikimin e nevojave të tregut të punës dhe nuk identifikon grupe specifike që

kanë nevojë për mbështetje të synuar, si të rinjtë, gratë, migrantët apo personat me aftësi të kufizuara.

Tranzicioni i gjelbër në dokumentet shqiptare konceptohet kryesisht si një proces mjedisor dhe teknik, jo si një transformim socio-ekonomik.

Gjithashtu Shqipëria nuk parashikon as buxhete konkrete apo angazhime financiare për investime në aftësi dhe trajnime në kuadër të tranzicionit të gjelbër, as role të qarta institucionale për ministritë apo agjencitë përgjegjëse. ETF vë në dukje se nuk ka një arkitekturë politike dhe institucionale që ta lidhë tranzicionin klimatik me zhvillimin e kapitalit njerëzor.

Në krahasim me vende si Mali i Zi, Maqedonia e Veriut apo Serbia, që shfaqin më shumë elemente pozitive ose pjesërisht të përfshira, Shqipëria del si një nga vendet më pak të përgatitura në aspektin social të tranzicionit të gjelbër. / Monitor



### SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

### KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

[www.kashalbania.org](http://www.kashalbania.org)

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



# KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

## KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



## ANALIZË

## Bujqësia, midis konsolidimit dhe rënies

*Eksportet e prodhimeve të freskëta u rritën me ritme dyshifrore si në vlerë dhe në sasi gjatë 8-mujorit 2025, por nga ana tjetër, sektori thelloi më tej rënien me 2.6% në 6-mujorin e parë. Fermerët dhe eksportuesit pohojnë se bujqësia po konsolidohet në ferma të mëdha të specializuara për eksport, teksa po falimentojnë fermat e vogla të bujqësisë tradicionale. Arsyet pse importet dhe eksportet e ushqimeve po rriten njëkohësisht. Kostot e anëtarësimit që po vënë me shpatulla pas muri bujqësinë. Serbia është partneri kryesor në eksporte, teksa tregjet e BE-së shfaqin luhajtje*

Rritja e eksporteve bujqësore si në sasi dhe në vlerë dhe në anën tjetër, rënia e prodhimit po tregon se sektori po shkon drejt konsolidimit. Fermat e vogla dhe të mesme në zonat e rurale të vendit po falimentojnë nga tkurrja dhe plakja e popullsisë, teksa po rriten dhe po zgjerohen fermat e mëdha blegtorale dhe ato në serra në zonat me bujqësi intensive si Fieri, Lushnja etj., me synim eksportin.

vjetore me 10% në tremujorin e tretë të këtij viti, duke reflektuar edhe tkurrjen e fortë

në zonat e Lushnjës, Divjakës, Fierit dhe Krugës, së bashku me përhapjen e teknologjive

një tkurrje të dukshme të bujqësisë në shkallë kombëtare.

Arsyeja kryesore është emigrimi masiv i fuqisë punëtore rurale, i cili ka lënë pas paraclara të shumta të papunuara dhe ka shtuar kostot e prodhimit për fermerët që vijojnë aktivitetin.

Shumë ferma të vogla nuk arrijnë të përballojnë shpenzimet gjithnjë e më të larta për plehra, farëra, pesticidet dhe naftën bujqësore, duke rezultuar në braktisje të tokës vit pas viti. Rënia e investimeve në fermat e vogla dhe të mesme në bujqësi ka reduktuar prodhimin total, duke bërë që sektori në tërësi të japë kontribut më të ulët në ekonomi.

tin 2014, duke nxjerrë në pah vështirësi të theksuara strukturore.

Importet e ushqimeve janë rritur si në sasi, ashtu edhe në vlerë monetare (lek), ndërsa çmimi mesatar për kilogram ka pësuar luhajtje të ndjeshme gjatë periudhës 2021–2025.

Sasia e ushqimeve të importuara nisi me rreth 904.7 milionë kg në vitin 2021 në 10-mujorin dhe ra lehtë në 2022, por më pas rritja bëhet e qëndrueshme vit pas viti, duke ndjekur rritjen e numrit të turistëve dhe rënien e prodhimit vendas.

Në 10-mujorin 2024, arrihet niveli 1.078 miliardë kg, ndërsa për 2025, sërish ka rritje të fortë, në 1.1 miliardë kg, duke shënuar nivelin më të lartë të pesëvjeçarit. Në vlerë monetare, importet kanë ndjekur të njëjtin trend rritës, por me luhajtje më të theksuara. Pasi u ngjiten në 138 miliardë lekë në vitin 2022, bien në 121.6 miliardë lekë në 2023, për t'u rritur sërish në 130.6 miliardë lekë në 2024 dhe të projektohen në 135.1 miliardë lekë për vitin 2025.

Çmimi mesatar për kilogram ushqim të importuar ka pësuar luhajtje nga krizat e viteve të fundit. Nga 116.6 lekë/kg në 2021, ai u rrit fuqishëm në 157.6 lekë/kg në 2022, si pasojë e inflacionit ndërkombëtar të ushqimeve dhe rritjes së kostove të transportit.

Më pas, çmimi shënon një korigjim në vitet 2023 dhe 2024, duke rënë përkatësisht në 132.3 dhe 121.1 lekë/kg, gjë që sugjeron stabilizim të tregjeve ndërkombëtare.

Në 10-mujorin 2025 ka rënie sërish me 120 lekë/kg, por ende shumë më poshtë krahasuar me kulmin e 2022, duke reflektuar stabilizim pas krizës.

### Dështoi sezoni i dytë i prodhimit

Sezoni i dytë i mbjelljeve që nxjerr prodhimin në dhjetor-janar në zonën e Myzeqesë po rezulton me humbje për prodhuesit, si rrjedhojë e dëmeve që sollën përmytjet e nëntorit dhe çmimet e ulëta të produkteve në tregjet e eksportit.

Fermeri Ziu tha se Shqipëria është konkurruese për sezonin e dytë të prodhimit, për shkak të favorizimit gjeografik dhe klimës duke eksportuar me çmime të larta perime të freskëta në tregjet e rajonit dhe më gjerë, që tashmë e ka mbyllur sezonin e të korrave.

Por këtë vit, situata ka ndryshuar në dëm të fermer-

ëve. Prodhimet për eksport në fushë – presh, lakra, karotë e etj., u dëmtoan tërësisht nga përmytjet e nëntorit. “Hum-bjet e mia në këtë sezon janë 2,5 milionë lekë (të reja) pasi rreth 30 dynymë lakër të mbjella në fushë u shkatërruan”, tha Mariglen Ziu.

Nga ana tjetër, çmimi i prodhimeve të dyta në tregjet e eksportit janë shumë të ulëta për shkak se moti i ngrohtë e ka favorizuar prodhimin edhe në vendet fqinje. Kjo bëri që në tregje të ketë prodhime të njaftueshme dhe çmimet të jenë shumë të ulëta.

Në 10-mujorin 2025, një kilogram fruta dhe zarzavate u shit nga eksportuesit me 64.9 lekë, sipas të dhënave të INSTAT, por në nëntor dhe dhjetor, çmimet janë edhe më të ulëta. Në vitin 2023, çmimi për kilogram ishte 76 lekë duke arritur nivelin më të lartë historik dhe pas kësaj po vjen me ulje.

Fermerët shqiptarë janë tërësisht të ekspozuar ndaj çmimeve të tregut, kostove të lëndëve të para dhe krizave klimatike, pasi nuk përfitojnë mbështetje financiare dhe nuk janë të përfshirë edhe në sistemin e sigurimeve.

Në vitin 2026, fermerëve do t'u shpërndahen 5.2 miliardë lekë në formën e subvencioneve dhe granteve sipas Ministrisë së Bujqësisë. Shqipëria vijon të ofrojë shumë më pak mbështetje për bujqësinë se Europa dhe Rajoni, teksa nuk po mundemi të përfitojmë nga fondet e BE-së, për shkak të korrupsionit që u gjet në përdorimin e tyre.

### Eksportet e zarzavateve, partneri kryesor Serbia, rritje e fortë me Poloninë

Eksportet e zarzavateve (pa frutat) arritën në 12.4 miliardë lekë me rritje 20% në vlerë. Tregu më i madh i eksportit këtë vit ishte me Serbinë. Drejt këtij vendi u eksportuan 2.6 miliardë lekë zarzavate, me rritje vjetore 25% duke zënë 21% të totalit të shitjeve të perimeve dhe zarzavateve nga janari në tetor 2025.

Të dhënat tregojnë qartë se struktura e eksporteve të zarzavateve shqiptare mbetet e përqendruar kryesisht në tregun rajonal, duke reflektuar një varësi të fortë nga vendet fqinje dhe Ballkani Perëndimor.

Një prirje e ngjashme vërehet edhe me Kosovën, Bosnjë-Hercegovinën dhe Maqedoninë e Veriut, ku eksportet janë rritur me ritme dyshifrore, duke konfirmuar se rajoni mbetet boshti kryesor i shkëmbimeve tregtare të Shqipërisë.

Edhe Kroacia dhe Bullgaria zënë një peshë të rëndësishme në hartën e eksporteve, ndonëse dinamika është e ndryshme. Ndërsa eksportet



Të dhënat e periudhës 2021–2025 tregojnë rritje të qëndrueshme dhe të fortë të eksporteve të zarzavateve dhe frutave, ku totali është zgjeruar me rreth 70%. Vlera e tyre arriti në mbi 17.1 miliardë lekë në 10-mujorin e 2025-s, nga 10.1 miliardë lekë në të njëjtën periudhë të vitit 2021.

Të krahasuara me 10-mujorin e 2024, eksportet e frutave dhe zarzavateve u rritën me 22% në vlerë.

Mariglen Ziu, fermer i cili operon në sektorin e prodhimit në fushë në zonën e Samaticës në Berat, thotë se prodhimi nuk po zgjerohet, por po manovrohet me disa kultura që besohet se rrisin vlerën. Për shembull, vitet e fundit, është rritur ndjeshëm eksporti i bostaneve dhe lakrave.

Frutat dhe zarzavatat dy vitet fundit kanë rritur ndjeshëm vlerën dhe sasinë e eksporteve. Kultivimi i tyre zakonisht bëhet në ferma të specializuara në shumë hektarë, si në serrë dhe në fushë për t'u eksportuar. Fermeri Ziu thotë se nuk po zgjerohet baza e njerëzve që po merret me bujqësi, përkundrazi numri i tyre po tkurret çdo ditë, por disa ferma të mëdha po zgjerohen sipërfaqet, tha ai.

Në anën tjetër, sektori bujqësor thelloi tkurrjen këtë vit me -2.6% në 6-mujorin e parë. Bujqësia është në vitin e pestë të rënies, si volum prodhimi. Ruzhdi Koni, eksportues me përvojë i prodhimeve bujqësore, tha se rritjet e shitjeve jashtë vendit po pasqyrojnë evolucionin e segmentit eksportues të bujqësisë, i cili është bërë gjithnjë e më i specializuar dhe më i lidhur me tregjet europiane.

Kjo, sipas tij, ka mundësuar rritjen e vlerës dhe sasisë së eksportit, pavarësisht sfidave të përgjithshme që po kalon sektori. Të dhëna nga INSTAT treguan se punësimi në sektorin bujqësor shënoi rënie

të popullsisë në fshat.

Në të njëjtën kohë, me rritjen e eksporteve bujqësore, po rriten edhe importet. Në 10-mujorin e këtij viti, grupi i ushqimeve shënoi rritje me 2% në sasi dhe në 3.4% në vlerë. Në mungesë të prodhimit të gjerë në ferma të vogla për treg dhe për vetëkonsum, tregu po furnizohet nga jashtë.

Në mes të problemeve me copëzimin e lartë, mungesën e subvencioneve, prodhuesit përballen me humbje të larta pas korrjeve. Më shumë se 25% e prodhimit në disa kultura përfundon në mbetje pas të korrave, për shkak të çmimit të ulët, ose mungesës së kapaciteteve magazinuese.

### Pse po rriten eksportet

Zoti Koni thotë se rritja e eksporteve bujqësore lidhet me disa faktorë që kanë vepruar pas pandemisë. Së pari, çmimet ndërkombëtare të frutave dhe zarzavateve janë rritur ndjeshëm pas vitit 2022, për shkak të inflacionit në grupin e ushqimeve.

Në të njëjtën kohë, ndryshimet klimatike dëmtoan prodhuesit e rëndësishëm si Italia, Spanja dhe Greqia. Shqipëria ka përfituar nga kjo situatë, duke qenë në gjendje të ofrojë produkte konkurruese në momente kur furnizuesit tradicionalë kishin ulur volumet. Kjo ka bërë që vlera e eksporteve të rritet dhe volumi real i prodhimit mund të ketë qenë më i moderuar.

Në shumë raste, eksportuesit shqiptarë kanë shitur sasi të ngjashme me të një vit më parë, por me çmime dukshëm më të larta, duke gjeneruar një rritje të shpërndarë në të gjithë zinxhirin ofertues.

Në të njëjtën kohë, Shqipëria ka konsoliduar një bërthamë të prodhuesve të mëdhenj, të aftë të konkurrojnë në tregjet ndërkombëtare. Zoti Ziu tha se investimet në serra

moderne të vaditjes, plehërim-it të kontrolluar dhe cikleve të prodhimit gjatë gjithë vitit, kanë rritur ndjeshëm vëllimin e prodhimit të orientuar drejt eksportit.

Këta prodhues tani operojnë me kontrata të qëndrueshme me kompani grumbulluese dhe tregtarë eksporti. Një rol të madh ka edhe ngritja e kapaciteteve të përpunimit dhe ruajtjes në magazina frigoriferike, linja seleksionimi, paketimi dhe certifikime si GlobalG.A.P.

Të dhënat tregojnë se çmimet e eksporteve po vijnë në rënie pas rritjes post-pandemike.

Nga viti 2021 deri në 2023, eksportet e grupit të ushqimeve në Lek u rritën dukshëm, nga rreth 35.9 miliardë lekë në vitin 2021 në mbi 46.3 miliardë lekë në vitin 2023.

Kjo periudhë shoqërohet edhe me rritje të sasisë së eksportuar, fakt që tregon ecuri pozitive të sektorit, e ndikuar si nga kërkesa e jashtme, ashtu edhe nga çmimet më të larta të produkteve ushqimore në tregjet ndërkombëtare.

Në vitin 2024, megjithëse sasia e eksporteve rritet sërish, pati një ulje të theksuar të çmimit mesatar për kilogram, i cili zbret nga 142.3 lekë/kg në vitin 2023 në vetëm 111.3 lekë/kg në vitin 2024.

Kjo për shkak se çmimet në tregjet ndërkombëtare ranë dhe gjithashtu u rrit eksporti i bostanit që peshon më shumë, po kushton më pak.

Në vitin 2025, vlera e eksporteve të ushqimeve ra më tej duke arritur në 108.7 lekë/kg në 10-mujorin 2025, niveli më i ulët i pesëvjeçarit. Kjo tregon se rritja e eksporteve në vlerë këtë vit nuk është pasojë e çmimeve më të larta, por nga zgjerimi i volumit të eksporteve.

Megjithatë, ky zhvillim pozitiv në segmentin eksportues ekziston paralelisht me

## ANALIZË

## Bujqësia, midis konsolidimit dhe rënies

(Vijon nga faqja 10)

drejt Bullgarisë janë rritur ndjeshëm me 26%, Kroacia shfaq rënie të lehtë, duke sinjalizuar luhatje të kërkesës ose ndryshime në strukturën e produkteve të eksportuara. Në tërësi, Ballkani vazhdon të dominojë, jo vetëm për shkak të afërsisë gjeografike, por edhe për shkak të kostove më të ulëta logjistike dhe lidhjeve tradicionale tregtare.

Zoti Koni tha se ka pasur rritje të fortë në pranverë, të lakrës dhe bostanit në tregjet e reja të BE-së, sidomos në Poloni dhe në disa vende nordike.

Eksportet e zarzavateve të freskëta në tregjet e Bashkimit Europian shfaqen më të fragmentuar. Italia, historikisht një nga partnerët kryesorë të Shqipërisë, shënon rënie të fortë të eksporteve, me mbi 38% më pak krahasuar me një vit më parë, duke dhënë një sinjal shqetësues për dobësimin e kërkesës ose zhvendosjen e flukseve tregtare.

Një rënie e ndjeshme vërehet edhe në Francë, Zvicër dhe Norvegji, gjë që tregon se eksportet shqiptare në disa nga tregjet e zhvilluara europiane po përballen me vështirësi.

Megjithatë, ka edhe përjashtime pozitive brenda BE-së. Eksportet drejt Gjermanisë u rritën me 97%, në Poloni, me 106%; në Rumani, 66%, dhe në Suedi, 145%, me rritje të fortë, për shkak të bazës së ulët që kanë, por edhe faktit se në këto tregje ka hapësirë për zgjerim dhe se disa sektorë po arrijnë të depërtojnë më mirë.

### Humbje të mëdha pas të korrave

Prodhimi pa planifikim dhe problemet në zinxhirin e furnizimit bëjnë që një pjesë e madhe e prodhimit bujqësor të përfundojë në mbeturina. Fermerët në zonën e Lushnjës pohuan se shpesh, gati gjysma e një kulture hidhet sërish në tokë.

Statistikat e bujqësisë kanë besueshmëri të ulët sipas Eurostat dhe qeveria nuk i orienton fermerët për prodhimet në bazë të planeve të konsumit të brendshëm.

Vendi nuk ka ende një sistem kombëtar monitorimi që t'i masë rregullisht për të gjitha kulturat. Raportet sektoriale tregojnë se humbjet e kulturave bujqësore variojnë nga 10% në mbi 50% për frutat. Humbjet përfshijnë dëmtimet në korrje, mungesën e frigoriferëve, dëmet gjatë transportit dhe ato në treg.

Vërehet se pas çdo cikli prodhimi, shumë fermerë detyrohen të hedhin sasi të konsiderueshme të frutave, jo sepse janë të parregullta për konsum, por sepse nuk kanë kushte për t'i ruajtur ose për t'i çuar me kohë në treg ose çmimet janë shumë të ulëta.

Mungesa e teknologjisë së duhur në fazën e korrjes po dëmton shumë fruta dhe perime nga trajtimi i pakujdesshëm. Në shumë zona, produkti mbetet me orë të tëra në diell para se të largohet nga parcela, duke përsheptuar kalbjen.

Më tej, faza e ruajtjes paraqet sfidat më të mëdha. Shqipëria ka kapacitete të kufizuara frigoriferike, shumë prej të cilave përdoren në mënyrë joefikase.

Studimet tregojnë se mungesa e ftohjes së menjëhershme pas korrjes, është një faktor kritik që rrit ndjeshëm humbjet, sidomos të mollët dhe agrumet. Paketimi i papërshtatshëm, higjiena e pamjaftueshme e magazinave dhe mjetet transportuese pa kontroll temperature i shtojnë më tej dëmet.

Gjatë transportit, humbjet thellohen nga rrugët e amortizuara dhe nga përdorimi i mjeteve që nuk janë frigoriferike, çka çon në dëmtime mekanike dhe rënie të cilësisë.

Në treg, sidomos në tregjet e

hapura, produktet ekspozohen ndaj temperaturave të larta, diellit, lagështisë apo kushteve të pasigurta të ruajtjes, duke bërë që frutat dhe perimet të humbin shpejt vlerën tregtare ose të dalin nga përdorimi.

Një studim i mëparshëm i CIHEAM, i vetmi me matje të drejtpërdrejta në tregjet e Korçës, gjeti se humbjet në hallkat e tregtimit për fruta si mollët, pjeshkat apo rrushi varionin nga 11% deri në mbi 17%, pa llogaritur humbjet në fushë e të transportit, që do ta rritnin edhe më shumë shifrën reale.

Humbjet pas korrjes në Shqipëri janë pasojë e strukturës së fragmentuar të bujqësisë, ku fermerat e vogla dhe individuale nuk kanë kapacitet të investojnë në depo, linja selektimi apo teknologji ruajtjeje. Mungesa e kooperativave funksionale, aksesit në tregje dhe shërbimeve këshillimore bujqësore e bën të vështirë standardizimin e praktikave moderne.

Sipas të dhënave zyrtare të Eurostat dhe Komisionit Europian, çdo vit në BE hidhet 60 milionë tonë ushqim, 130 kg ushqim i hedhur për frymë në vit.

Kjo përfshin ushqimin e humbur dhe të hedhur në të gjithë zinxhirin ushqimor nga prodhimi në fermë, përpunimin, shpërndarjen, dyqanet, restorantet e deri te shtëpitë e konsumatorëve. Humbjet në BE janë më të ulëta se në Shqipëri pasi zinxhirët e furnizimit dhe ekonomia qarkulluese funksionojnë të mirorganizuar.

### Kostot e bujqësisë nga anëtarësimi në BE

Shqipëria synon të bëhet vend anëtar i BE-së deri në vitin 2030, por për t'u përshtatur me standardet e Bashkimit Europian (BE) në kuadër të procesit të anëtarësimit, bujqësia duhet të kalojë nga një sektor kryesisht informal dhe

me produktivitet të ulët, në një sistem të formalizuar, të certifikuar dhe të qëndrueshëm, në përputhje me Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP) të BE-së.

Për një fermë mesatare perimesh ose frutash 10–15 ha në fazën e parë vjen kostoja e certifikimit për kriterin GlobalG.A.P., që është praktikisht kusht bazë për shumë importues europianë, shpenzimi fillestar për përgatitje, dokumentacion dhe auditim varion zakonisht nga 1.500 deri në 3.000 euro.

Më pas, certifikimi duhet rinovuar çdo vit, me një kosto vjetore që shkon nga 800 deri në 1.500 euro, në varësi të madhësisë së fermës dhe numrit të parcelave. Ruzhdi Koni, i cili eksporton prej vitesh prodhime bujqësore, thotë se koston e përshtatjes për të gjithë zinxhirin bujqësor shqiptar janë shumë të larta për kapacitetet e fermave shqiptare.

Pas certifikimit, vjen formalizimi dhe administrimi. Regjistrimi i aktivitetit, kontabiliteti, deklarimet fiskale dhe shërbimet bazë administrative kushtojnë mesatarisht 600 – 1.200 euro në vit. Këto janë kosto që më parë mungonin për fermerin informal, por bëhen të domosdoshme për eksport.

Një tjetër zë i rëndësishëm është gjurmueshmëria dhe dokumentacioni teknik. Standardet e BE-së kërkojnë regjistrat e prodhimit, përdorimit të pesticideve, këshillim agronomik dhe në disa raste, përdorimin e sistemeve digjitale të thjeshta me shpenzime shtesë rreth 500 – 1.000 euro në vit, kryesisht për shërbime këshillimore dhe menaxhim dokumentacioni.

Kostot rriten ndjeshëm kur futemi tek analizat laboratorike. Zoti Koni thotë se për çdo ngarkesë eksporti kërkojnë analiza për mbetje pesticidesh dhe parametra të tjerë. Një

analizë e plotë për një produkt të freskët kushton zakonisht 150 – 300 euro për ngarkesë. Nëse një eksportues dërgon 20 – 30 ngarkesa në vit, vetëm analizat mund të arrijnë 3.000 – 7.000 euro në vit.

Në nivel tregu, ka edhe kosto kontraktuale dhe rrezik komercial. Për të përmbyshur kontratat me importuesit europianë, eksportuesi duhet të mbajë rezerva, të sigurojë furnizim alternativ dhe të përballojë humbje nga refuzimi i ndonjë ngarkese.

Ekspertët e sektorit përllogarisin se, kostoja fillestare për hyrje në eksport drejt BE-së (certifikim + investime bazë) mund të arrijë në 25.000 – 50.000 euro, ndërsa kostoja vjetore e mirëmbajtjes së standardeve varion zakonisht nga 6.000 deri në 12.000 euro, pa llogaritur rreziqet tregtare.

BE ka rregulla shumë të rrepta për ushqimin që qarkullon në tregun e përbashkët. Shqipëria duhet të zbatojë plotësisht standardet HAÇP, ISO 22000 dhe GlobalG.A.P.

### Anëtarësimi na bën jokonkurrues

Në perspektivën e anëtarësimit në BE, eksportet bujqësore shqiptare do të përballen me një presion edhe më të madh konkurrues. Hapja e plotë e tregut do të thotë më shumë mundësi për eksport, më shumë konkurrencë nga prodhues të konsoliduar europianë.

Ekspertët thonë se pa investime serioze në standarde, organizim dhe përpunim, ekziston rreziku që bujqësia shqiptare të mbetet kryesisht furnizuese e tregjeve periferike ose të eksportoje vetëm produkte me vlerë të ulët. Nëse arrijnë të kalojnë nga eksporti i rastësishëm tek eksporti i certifikuar, bujqësia shqiptare mund të shndërrohet në një nga sektorët më të prekshtëm pozitivisht nga integrimi europian.

Eksportet shqiptare bujqësore drejt Bashkimit Europian mbeten ende të kufizuara në vëllim dhe të përqendruara në pak produkte, pavarësisht potencialit që ka vendi ynë për shkak të klimës, pozicionit gjeografik dhe kostos relativisht të ulët të prodhimit.

Aktualisht, Shqipëria eksporton kryesisht fruta dhe perime të freskëta, bimë mjekësore e aromatike, vaj ulliri dhe, në një masë më të vogël, produkte të përpunuara. Megjithatë, prania në tregun europian është ende e brishtë dhe e paqëndrueshme, pasi një pjesë e madhe e eksporteve realizohet në mënyrë sezonale dhe pa kontrata afatgjata.

Pengesë kryesore për rritjen e eksporteve mbetet përmbyshja e standardeve të sigurisë ushqimore dhe e kërkesave teknike të BE-së. Tregu europian kërkon gjurmueshmëri të plotë të produktit, dokumentacion të saktë mbi përdorimin e pesticideve, certifikime të njohura në rang ndërkombëtar dhe kontrolle të rregullta laboratorike.

Në shumë raste, fermerët shqiptarë prodhojnë cilësi të mirë, por nuk arrijnë ta dokumentojnë atë sipas rregullave të BE-së, çka e bën produktin të papranueshëm për importuesit europianë. Kjo krijon një hendek mes potencialit real të prodhimit dhe aftësisë për ta shndërruar atë në eksport të qëndrueshëm.

Megjithatë, në disa nënsektorë, Shqipëria ka arritur të krijojë një pozicion më të qëndrueshëm. Bimët mjekësore dhe aromatike janë shembulli pozitiv, pasi vendi ka përfutur nga tradita, biodiversiteti dhe integrimi më i hershëm në zinxhirë eksporti të strukturuar.

Edhe në këtë rast, vlera e shtuar mbetet e kufizuar, pasi eksportet realizohen kryesisht në formë lënde të parë dhe jo si produkte të përpunuara me markë shqiptare.

"Monitor"

## Shqipëria po humbet tregjet e rajonit

*Rënia e eksporteve drejt Serbisë, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, ndërsa importet rriten më 2025, po e kthen tregtinë rajonale nga një burim suficitit në një presion të ri mbi ekonominë shqiptare. Në dy vjet, Shqipëria ka humbur rreth 12 miliardë lekë suficitit vetëm me Kosovën dhe mbi 5 miliardë lekë eksporte me Serbinë, ndërsa importet nga rajoni po rriten me ritme 5 – 20% në vit. Nga një suficit prej 12.8 miliardë lekësh në vitin 2024, bilanci tregtar me rajonin ra në vetëm 3.3 miliardë në 2025, ndërsa eksportet u turrën me 7% dhe importet u rritën me gati 8%. Arsyet*



me rreth 7%. Në të njëjtën kohë, importet u rritën në 59.4 miliardë lekë, nga 54.7 miliardë lekë një vit më parë, ose gati 8% më shumë, sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT.

Këto zhvillime kanë përkeqësuar ndjeshëm bilancin tregtar. Në vitin 2024, Shqipëria kishte një suficit prej 12.8 miliardë lekësh në tregtinë me rajonin, ndërsa në vitin 2025 ai u ngushtua në vetëm 3.3 miliardë lekë,

një përkeqësim prej afro 9.5 miliardë lekësh brenda një viti, me turrje rreth 280%. Vendi ynë humbi avantazhin që kishte ndërtuar gjatë viteve të fundit në tregjet fqinje.

Të dhënat tregojnë se problemi nuk qëndron vetëm te rritja e importeve, por sidomos te dobësimi i eksporteve, të cilat kishin arritur kulmin në vitin 2023 me mbi 79 miliardë lekë, por prej atëherë janë në rënie të vazhdueshme. Brenda dy vitesh, eksportet drejt rajonit kanë humbur më shumë se 16 miliardë lekë në vlerë.

Kjo prirej sugjeron se prodhuesit shqiptarë po humbin terren në tregjet e rajonit, përballë konkurrencës më të fortë nga vendet fqinje, kostove më të larta të prodhimit dhe

(Vijon në faqen 12)

## Shqipëria po humbet tregjet e rajonit

(Vijon nga faqja 11)

një strukturë eksporti ende të varur nga produkte me vlerë të ulët të shtuar.

Nëse kjo tendencë vazhdon, tregtia me rajonin, e cila tradicionalisht ka qenë një nga pikat më të forta të eksporteve shqiptare, rrezikon të kthehet në një tjetër kanal presioni mbi bilancin tregtar të vendit.

Në kushtet kur edhe tregjet e BE-së po shfaqin ngadalësim, humbja e terrenit në rajon e bën edhe më të brishtë pozicionin e jashtëm të ekonomisë shqiptare.

Ruzhdi Koni, eksportues i prodhimeve të freskëta bujqësore, tha se edhe këtë vit, përkeqësimi do të thellohet për shkak të dëmeve që krijuan përmbytjet e fundit në fusha dhe në serra, shumica e tyre për eksport.

Nga eksportet në rajon, grupet me rënie më të madhe ishin materialet e ndërtimit, energjia dhe lëndët djegëse, të diktuar nga cikli i tkurrjes që po kalon sektori i industrisë.

Volumi tregtar i Shqipërisë me rajonin ishte 122 miliardë lekë në vitin 2025, pothuajse në të njëjtin nivel me 2024-n, dhe zuri 9.9% të volumit të përgjithshëm tregtar të vendit me jashtë.

Kosova është partneri kryesor tregtar me gati 43% të tregtisë me të gjithë rajonin, e ndjekur nga Serbia me 26%, Maqedonia e Veriut me 19.5% dhe të tjerat më pak.

### Serbia po thellon epërsinë ndaj Shqipërisë, deficitin tregtar rritet edhe në vitin 2025

Tregtia e Shqipërisë me Serbinë po lëviz gjithnjë e më shumë në disfavor të ekonomisë shqiptare, duke u shndërruar në një nga pikat më problematike të bilancit tregtar me rajonin. Të dhënat për vitin 2025 tregojnë se, pavarësisht rritjes të lehtë të eksporteve, deficitin tregtar me Serbinë është thelluar edhe më tej.

Eksportet shqiptare drejt Serbisë arritën në 8.55 miliardë lekë në vitin 2025, nga 8.27 miliardë lekë në vitin 2024, duke shënuar një rritje modeste prej 3.3%. Megjithatë, kjo rritje nuk ka qenë e mjaftueshme për të kompensuar zgjerimin e importeve nga Serbia, të cilat u rritën me 5.8%, duke arritur në 23.1 miliardë lekë.

Si rezultat, deficitin tregtar i Shqipërisë me Serbinë u thellua në 14.56 miliardë lekë në vitin 2025, nga 13.50 miliardë lekë një vit më parë, një përkeqësim prej mbi 1 miliard lekësh vetëm brenda një viti.

Kjo do të thotë se për çdo 1 lek që Shqipëria eksporton drejt Serbisë, ajo importon gati 2.7 lekë mallra serbe, duke e bërë marrëdhënien tregtare të pabalancuar. Nëse krahasohen me vitin 2022, kur

eksportet drejt Serbisë kishin arritur një kulm prej 13.5 miliardë lekësh, rënia është edhe më e fortë. Brenda tre vitesh, eksportet shqiptare drejt tregut serb u tkurrën me rreth 5 miliardë lekë (rreth 50 milionë euro), ndërsa importet mbeten të larta dhe relativisht të qëndrueshme.

Goditja më e fortë është te materialet e ndërtimit dhe metalet, ku eksportet shqiptare ranë me rreth 805 milionë lekë ose 7% vetëm në vitin 2025. Grupi tjetër me rënie më të fortë, 24%, ishin mineralet, lëndët djegëse dhe energjia elektrike, me afro 382 milionë lekë ose -24% më pak eksporte, çka tregon se Shqipëria po humb edhe në segmentet ku kishte avantazh kostoje.

Nga ana tjetër, importet e ushqimeve dhe pijeve nga Serbia u rritën me mbi 617 milionë lekë në vitin 2025 ose 5.5%, duke reflektuar rritjen e varësisë së tregut shqiptar nga produktet ushqimore serbe. Edhe importet e produkteve kimike dhe plastike u rritën me rreth 249 milionë lekë ose 8.2%, ndërsa materialet e ndërtimit dhe metalet u shtuan me afro 290 milionë lekë, ose 7.5%.

Të dhënat tregojnë se Serbia po zgjeron praninë e saj në Shqipëri, si furnizues jo vetëm i ushqimeve, por edhe i produkteve industriale, duke e shtyrë prodhimin vendas drejt një konkurrence gjithnjë e më të vështirë.

Të dhënat sugjerojnë se prodhuesit shqiptarë po humbasin hapësirë në tregun serb, ndërkohë që mallrat serbe po forcojnë praninë e tyre në tregun shqiptar. Kjo tendencë reflekton dobësinë strukturore të eksporteve shqiptare, të përqendruara në produkte me vlerë të ulët të shtuar dhe me kapacitete të kufizuara për të depërtuar në tregje më të mëdha.

Në kontekstin rajonal, Serbia po shfaqet gjithnjë e më shumë si një "qendër eksportuese" e Ballkanit Perëndimor, ndërsa Shqipëria po rrezikon të mbetet treg konsumi.

### Shqipëria po humb edhe tregun e Kosovës, suficitin bie me 20% brenda një viti

Kosova, tradicionalisht tregu më i rëndësishëm rajonal për eksportet shqiptare, po jep shenja ftohjeje për mallrat nga Shqipëria. Të dhënat për vitin 2025 tregojnë se eksportet shqiptare drejt Kosovës ranë në 33.65 miliardë lekë, nga 36.83 miliardë lekë në vitin 2024, me tkurrje vjetore prej 9.5%. Kjo është rënia më e fortë vjetore e eksporteve drejt Kosovës gjatë pesë viteve të fundit të marra në analizë.

Humbja më e madhe vjen nga materialet e ndërtimit

dhe metalet, ku eksportet janë tkurrur me rreth 8.7 miliardë lekë brenda një viti, ose 73% më pak. Furnizuesit nga Serbia, Maqedonia e Veriut dhe Turqia po zëvendësojnë gjithnjë e më shumë produktet shqiptare në sektorë si çimentoja, hekuri, alumini dhe materialet e ndërtimit.

Edhe produktet kimike dhe plastike kanë pësuar rënie të fortë prej mbi 1 miliard lekësh ose 28%, duke konfirmuar se Kosova nuk po humbet vetëm si treg konsumi, por edhe si hapësirë për industrinë përpunuese shqiptare.

Në të njëjtën kohë, importet nga Kosova drejt Shqipërisë u rritën me 2.3%, duke arritur në 16.13 miliardë lekë.

Importet e mineraleve, lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike u rritën me mbi 1.4 miliardë lekë, ose 35%, si pasojë e blerjeve të energjisë elektrike, pjesë e marrëveshjeve për shkëmbimin e energjisë.

Edhe importet e produkteve kimike dhe plastike u rritën me mbi 120 milionë lekë ose 9.5%, ndërsa tekstilet dhe këpucët u shtuan ndjeshëm me rreth 29.5%.

Si pasojë, suficitin tregtar i Shqipërisë me Kosovën ra në 17.52 miliardë lekë në vitin 2025, nga 21.07 miliardë lekë në vitin 2024, një përkeqësim prej 3.54 miliardë lekësh, ose mbi 20%, brenda vetëm një viti.

Rënia është edhe më e thellë nëse krahasohet me vitin 2023, kur suficitin kishte arritur mbi 29 miliardë lekë. Brenda dy vitesh, Shqipëria ka humbur rreth 12 miliardë lekë suficitin në tregtinë me Kosovën.

Ky zhvillim ka një peshë të veçantë, sepse Kosova përbën destinacionin më të madh rajonal për eksportet shqiptare. Dobësimi i këtij tregu dëshmon probleme më të thella në prodhimin shqiptar, pasi me Kosovën barrierat doganore janë minimale dhe avantazhi i gjuhës duhet të favorizonte Shqipërinë.

### Edhe Maqedonia e Veriut po largohet nga mallrat shqiptare

Shqipëria po humbet terren edhe në tregtinë me Maqedoninë e Veriut, një tjetër partner i rëndësishëm rajonal, duke e kthyer këtë marrëdhënie nga suficit në një burim të ri deficitin tregtar.

Në vitin 2025, eksportet shqiptare drejt Maqedonisë së Veriut ranë ndjeshëm në 8.99 miliardë lekë, nga 11.8 miliardë lekë në vitin 2024, rënie vjetore prej gati 24%. Kjo është rënia më e fortë e eksporteve drejt këtij tregu gjatë pesë viteve të fundit.

Rënia më e fortë e eksporteve drejt Maqedonisë së Veriut është për "materialet e ndërtimit dhe metalet", me

afro 3 miliardë lekë më pak ose -65% eksporte, duke e kthyer këtë treg nga një burim suficient në deficit të pastër për Shqipërinë.

Grupi i dytë me ndikimin më të lartë ishin eksportet e mineraleve dhe energjisë, të cilat janë tkurrur ndjeshëm me 8%. Ndërkohë, importet nga Maqedonia e Veriut drejt Shqipërisë u rritën me 16.7%, duke arritur në 14 miliardë lekë në vitin 2025, nga 12.06 miliardë lekë një vit më parë.

Rritja e importeve është edhe më e fortë dhe më e gjerë me Maqedoninë e Veriut. Importet e mineraleve dhe energjisë u rritën me mbi 2.4 miliardë lekë, ose 128% vitin e kaluar, duke u bërë burimi kryesor i rritjes së tregtisë me këtë vend.

Edhe importet e ushqimeve u rritën me 7%, makineritë dhe pajisjet me 42%, ndërsa tekstilet dhe produktet e drurit shënuan rritje të ndjeshme. Vetëm materialet e ndërtimit pësuan rënie të fortë, me mbi 1.1 miliardë lekë më pak importe, por kjo nuk e kompensoi rritjen e fortë të importeve në grupet e tjera të mallrave. Kjo do të thotë se Shqipëria po varet gjithnjë e më shumë nga Maqedonia e Veriut për furnizime energjetike dhe mallra industriale.

Në vitet 2022 dhe 2023, Shqipëria kishte epërsi në tregtinë me Maqedoninë e Veriut, por e humbi këtë avantazh në dy vitet në vijim. Bilanci tregtar u përkeqësua ndjeshëm. Nga një deficit relativisht i moderuar prej 261 milionë lekësh në vitin 2024, Shqipëria kaloi në një deficit të thellë prej 5.09 miliardë lekësh në vitin 2025, një përkeqësim prej mbi 4.8 miliardë lekësh brenda një viti.

Kjo përmbysje reflekton rënie të shpejtë të konkurrueshmërisë së eksporteve shqiptare në vendin fqinj, ndërkohë që mallrat nga Maqedonia e Veriut po fitojnë terren në tregun shqiptar.

### Mali i Zi, i vetmi treg ku Shqipëria po reziston

Në vitin 2025, Mali i Zi mbeti i vetmi partner fqinj ku Shqipëria arriti të ruajë një pozicion relativisht të qëndrueshëm. Në vitin 2025, eksportet shqiptare drejt Malit të Zi arritën në 8.0 miliardë lekë, nga 7.47 miliardë lekë në vitin 2024, duke shënuar një rritje prej 7.3%.

